




Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



ZBATIMI I STRATEGJISË PËR PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE ROM DHE ASHKALI NË SHOQËRINË KOSOVARE NË VITIN 2017

RAPORT VLERËSIMI



**ZBATIMI I
STRATEGJISË PËR
PËRFSHIRJEN E
KOMUNITETEVE ROM DHE
ASHKALI NË SHOQËRINË
KOSOVARE NË VITIN 2017**

RAPORT VLERËSIMI

Dhjetor 2017

Raport vlerësimi i zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare në vitin 2017

Hartimit të këtij raporti i kontribuan:

Kushtrim Bajrami (autor), Jusuf Thaçi, Diana Cena, Samir Shahini, Drilon Krasniqi, Arben Shala, Veton Sylhasi, Bekim Syla, Vlora Latifi, Driton Berisha.

Design: *envinion*

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	6
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Hyrje	12
1. Konteksti	14
1.1. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.....	17
2. Arsimi.....	22
2.1. Pjesëmarrja në Edukimin Parashkollor dhe Parafillor	27
2.2. Pjesëmarrja në Arsimin fillor dhe të Mesëm	31
2.3. Braktisja e Shkollimit.....	37
2.4. Qendrat Mësimore	39
2.5. Arsimi i Lartë për Komunitetet	41
3. Punësimi dhe Mirëqenia Sociale	44
3.1. Papunësia dhe Tregu i Punës.....	45
3.2. Ndihma Sociale dhe Pensione.....	52
3.3. Punësimi në Sektorin Publik.....	58
4. Rekomandimet	60



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Ky raport është hartuar me mbështetjen e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe projektit të financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), “Iniciativë e Kosovës për Integrim 2020 – KOSINT”. Projektet KEEN dhe KOSINT zbatohen nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Agjencinë për Përkrahjen e Punësimin në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Akademinë e Trajnimeve dhe Asistencës Teknike (ATTA) Stichting SPARK, Syri i Vizionit (SiV), Qendra për Zhvillim të Romëve dhe Ashkalinjve (RADC). Përmbajtja e këtij publikimi, në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian apo Fondacionit i Kosovës për Shoqëri të Hapur.

Lista e shkurtesave

APRK	Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BSFK	Balkan Sunflowers Kosova
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
EPMPB	Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obligueshëm
F	Femra
Gj	Gjithsej
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
KKV	Komitetet Komunale Vepruese
KOSINT	Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020
M	Meshkuj
MAP	Ministria e Administratës Publike
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MATP	Masat Aktive të Tregut të Punës
MICS	Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptianë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PATP	Politikat Aktive të Tregut të Punës
PLV	Planet Lokale të Veprimit
QAP	Qendrat e Aftësimi Profesional
QM	Qendrat Mësimore
QPS	Qendrat për Punë Sociale
RADC	Qendra për Dokumentim Rom dhe Ashkali
SIMP	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit
SiV	Syri i Vizionit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsim
SNS	Skema e Ndihmës Sociale
Strategjia	Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017 - 2021
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport ofron një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit mbi zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare në vitin 2017, i cili njëherit është dokument bazë zhvillimor për integrimin e këtyre komuniteteve si dhe forcimin e karakterit multietnik dhe multikulturor të shoqërisë kosovare.

Monitorimi është realizuar gjatë vitit 2017 dhe është përqendruar në dy nga katër fushat e veprimit të cilat adresohen në Strategjinë për Komunitete, përfshirë: Arsimin dhe Punësimin dhe Mirëqenien Sociale. Në këtë drejtim, gjatë procesit të monitorimit është analizuar gjendja aktuale e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe zotimet e Qeverisë së Kosovës kundrejt realizimit të objektivave për dy fushat e lartpërmendura si dhe masave dhe aktivitetet të parapara në këtë Strategji për vitin 2017.

Si rrjedhojë, të gjeturat e këtij raporti tregojnë se zbatimi i Strategjisë në vitin e parë të zbatimit të saj mbetet larg përmbushjes së aktivitetet të përcaktuara, kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit politik, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për monitorimin e progresit, si dhe koordinimit jo të mirë të institucioneve në nivel qendror dhe lokal.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si institucion përgjegjës i ngarkuar për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj. Kjo mungesë e kapaciteteve ka ndikuar negativisht në koordinimin institucional dhe vendosjen e një sistemi të rregullt institucional për monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë në nivel qendror dhe lokal. Në anën tjetër, komunat nuk kanë krijuar mekanizma për monitorim të zbatimit të Strategjisë, siç është planifikuar në Strategji, si dhe nuk kanë ndarë mjete financiare për vitin 2017. Pengesat në zbatimin e Strategjisë në nivel lokal janë të ndikuara nga vonesa të institucioneve përgjegjëse qendrore në finalizimin e termave të referencës për Komitetet Komunale Vepruese.

Të gjeturat kryesore nga monitorimi i Strategjisë janë:

- ✓ Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit ka shënuar përparim të dukshëm në 17 vitet e fundit, veçanërisht në arsimin fillor (klasat 1-5) ku pjesëmarrja ka tejkaluar 85%. Megjithatë, krahasuar me mesataren e Kosovës, pjesëmarrja nuk është ende në nivel të kënaqshëm dhe shkon duke u zvogëluar dukshëm në nivelet më të larta të sistemit të arsimit.
- ✓ Nuk është hartuar rregullorja për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel parashkollor dhe shkollat e mesme të larta.

- ✓ Fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, e veçanërisht vajzat, vazhdojnë të ballafaqohen me një shkallë të lartë të braktisjes së shkollimit. Ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit janë: kushtet e rënda ekonomike, niveli i lartë i papunësisë, niveli i ulët i edukimit dhe vetëdijes së prindërve mbi rëndësinë e shkollimit, diskriminimi në shkolla, qasja në infrastrukturë përkatëse deri në shkollë, mungesa e mësuesve me origjinë rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe migrimi i familjeve për arsye ekonomike dhe kthimi prapa në Kosovë.
- ✓ Përkundër aktivitetet të parapara në Strategji, gjatë vitit 2017, autoritetet qendrore dhe lokale nuk kanë organizuar asnjë aktivitet ndërgjegjësues mbi rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme, rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimit të rregullt. Si rrjedhojë, pjesa me e madhe e këtyre programeve vazhdojnë të organizohen nga organizatat e shoqërisë civile.
- ✓ Gjatë vitit 2017, Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë nga masat e parapara në Strategji për stimulimin e vijimit të edukimit parashkollor për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirë mbështetjen e programeve parashkollorë me bazë në komunitet dhe subvencionimin e pagesave për regjistrim në institucione parashkollorë publike.
- ✓ MASHT në bashkëpunim me partnerët zhvillimor ndërkombëtarë dhe organizatat jo-qeveritare (KFOS, KEC, HEKS, VoRAE, REF), kanë vazhduar programin për ofrimin e bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët vijojnë shkollimin e mesëm të lartë. Në vitin 2017 në nivel vendi janë ofruar rreth 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- ✓ EPRBM në nivel komunal dhe shkolle janë themeluar në shumicën e komunave të Kosovës, mirëpo vazhdojnë të mos jenë funksionale në disa komuna dhe nuk ka monitorim të punës së tyre.
- ✓ Nuk janë hartuar planet e veprimit për parandalimin e braktisjeve, si pjesë e planeve zhvillimore të shkollave apo komunave. Të vetmit akterë që punojnë në parandalim të braktisjes janë mediatorët e angazhuar nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare.
- ✓ Një hap pozitiv drejt njohjes së punës së qendrave mësimore dhe përfshirjes së veprimtarisë së tyre brenda kuadrit institucional është aprovimi i Udhëzimit Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore, nga MASHT në gusht të vitit 2017.
- ✓ Pavarësisht se universitetet publike në Kosovë kanë kuota të caktuara për regjistrimin e studentëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, numri i tyre që regjistrohen në arsimin universitar përkatësisht në fakultet vazhdon të mbetet tejte i ulët.
- ✓ Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2017, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për sigurimin e kurseve intensive për përgatitjen e kandidatëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për provimin pranues apo programe të mentorimit për t'i mbështetur ata gjatë studimeve.
- ✓ Papunësia në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë më e madhe se te komunitetet e tjera etnike në Kosovë. Situata në tregun e punës është edhe më e rëndë për gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, prej të cilave vetëm 9% janë të punësuar.

- ✓ Përkundër aktiviteteve të parapara në Strategji, gjatë vitit 2017, MPMS nuk ka organizuar asnjë fushatë informimi për shërbimet e punësimit dhe MATP-ve, përfshirë trajnimet profesionale. Po ashtu, MPMS ka dështuar në punësimin e këshilltarëve të punësimit nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.
- ✓ Institucionet në Kosovë kanë dështuar në zbatimin e obligimeve ligjore që garantojnë përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil në të dy nivelet, atë komunal dhe qendror. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës në krahasim me pjesëmarrjen që kanë në totalin e popullsisë në një komunë të caktuar vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në shërbimin civil si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal.

Nga të gjeturat e analizës janë nxjerrë këto rekomandime:

- ✓ Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të organizojnë fushata të ndryshme për vetëdijësimin e mësimeve dhe nxënësve për të luftuar diskriminimin në shkolla.
- ✓ Për shkak të kostos së papërbalueshme për vijimin e edukimit parashkollor në çerdhe ose kopshte publike dhe private, komunat duhet të ndajnë kuota të caktuara dhe të mbulojnë shpenzimet e çerdheve publike për vijimin e së paku një numri të caktuar të fëmijëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- ✓ Qendrat Mësimore duhet të vazhdojnë të përkrahen nga donatorët si dhe nga institucionet lokale dhe qendrore, në mënyrë që të rrisin kapacitetet dhe cilësinë e punës së tyre me fëmijë. MASHT duhet të zbatojë kornizën ligjore për funksionimin e QM-ve, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore.
- ✓ Në mënyrë që të rritet numri i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që vijnë në klasën parafillore, shkollat duhet të rrisin numrin e klasave parafillore.
- ✓ Me qëllim të uljes së rasteve të braktisjes së shkollimit dhe zvogëlimin të numrit të mungesave gjatë shkollimit të mesëm të ulët, rekomandohet të ndërmerren disa masa, si: organizimi i fushatave vetëdijësuese për prindërit mbi rëndësinë e shkollimit; përkrahja e nxënësve me gjendje të rënde sociale me pako shkollore dhe me veshmbathje; trajnimi i mësimeve të mësimdhënësve lëndorë për qasje sa më përfshirëse; funksionalizimi dhe monitorimi i ekipeve përkatëse për parandalimin e braktisjes në shkolla.
- ✓ Për të ndikuar në përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian gjatë shkollimit, përveç masave të parapara për rritjen e vijueshmërisë dhe parandalimin e braktisjes së shkollimit, duhet të ndërmerren edhe masa të tjera, si: rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dhe posaçërisht në klasën parafillore; zvogëlimi i mungesave të këtyre nxënësve gjatë shkollimit; ofrimi i mësimit shtesë dhe orëve plotësuese nga shkollat dhe mësimeve të mësimdhënësve; zhvillimi i programeve për zhdukjen e analfabetizmit tek prindërit e këtyre nxënësve; përkrahja e familjeve me gjendje të rënde ekonomike nga donatorët dhe institucionet qendrore e lokale.

- ✓ Me qëllim të rritjes së numrit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që regjistrohen në studime universitare, donatorët dhe institucionet lokale dhe qendrore duhet të vazhdojnë t'i përkrahin me bursa studentët e suksesshëm dhe studentët e familjeve me gjendje të rënde sociale (me theks të veçantë atyre të gjinisë femërore). Po ashtu, duhet të organizohen kurse përgatitore për provim pranues si dhe programe të mentorimit për t'i mbështetur studentët e këtyre komuniteteve gjatë studimeve.
- ✓ MPMS në statistikat e rregullta duhet të raportojë në nivel të komuniteteve specifike dhe duhet të publikojë raporte mbi përfitimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga shërbimet e punësimit dhe asistencës sociale dhe masat tjera të ofruara.
- ✓ Me qëllim të informimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, MPMS duhet të organizojë fushata informuese për skemat e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale si dhe kriteret për qasje në këto skema. Po ashtu, kriteret e vlerësimit për të përfituar nga ndihma sociale nuk janë të përshtatshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe duhet rishikuar.
- ✓ Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë mekanizma për monitorim dhe raportim të rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore për sigurimin e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucione publike në nivel qendror dhe lokal.

Hyrje

Me qëllim të vlerësimit të nivelit të zbatimit të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 dhe të efektivitetit të masave të parapara me këtë strategji, projekti i financuar nga Bashkimi Evropian “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim – KEEN”, ka zhvilluar një kornizë gjithëpërfshirëse monitorimi të përqendruar në monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe rezultateve të synuara të Strategjisë.

Për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të strategjisë, aktivitetet përkatëse janë zberthyer dhe janë shndërruar në pyetje për të gjitha aspektet, segmentet dhe etapat konkrete të atyre aktiviteteve, si dhe janë identifikuar burimet e ndryshme konkrete për lehtësimin e monitorimit dhe për verifikimin e zbatimit të atyre aktiviteteve.

Po ashtu, për këtë qëllim, më 23 dhe 24 tetor 2017 janë organizuar katër fokus grupe me pjesëmarrës palë të ndryshme të interesit, si vijon:

- ✓ Një fokus grup është organizuar me prindër të fëmijëve dhe nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët vijojnë mësimin (parashkollor ose mësimin shtesë) në Qendra Mësimore dhe shkollimin e rregullt në shkollë fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë.
- ✓ Një fokus grup është organizuar me mësime dhënëse të shkollave të rregullta (klasat 1-12), të cilët japin mësim në shkollat dhe klasat që vijojnë mësimin nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- ✓ Një fokus grup është organizuar me pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që punojnë në Qendra Mësimore (Tutorë, Fasilitatorë ose Koordinatorë në Qendra Mësimore), ku vijojnë mësimin (parashkollor ose mësimin shtesë) fëmijët dhe nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- ✓ Një fokus grup është organizuar me persona që punojnë në projekte ose organizata jo-qeveritare që angazhohen ekskluzivisht ose kryesisht me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Në këto fokus grupe kanë marrë pjesë gjithsej 30 persona të moshës prej 20 deri 61 vjeçare, prej të cilëve 12 femra dhe 18 meshkuj, shumica pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Pjesëmarrësit në fokus grupe kanë qenë nga 11 komuna të ndryshme të Kosovës, në të cilat jetojnë më shumë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përkatësisht nga këto komuna: Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji, Fushë Kosova, Graçanica, Lipjani, Obiliqi, Klina dhe Istogu.

Ky raport synon të ofrojë një vlerësim të hollësishëm të situatës së romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë në fushën e arsimit dhe punësimit dhe mirëqenies sociale, duke analizuar situatën kundrejt zotimeve të Qeverisë së Kosovës për të zbatuar Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.

Raporti i monitorimit përbëhet nga katër seksione. Në seksionin 1 jepen informata të përgjithshme për Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare dhe zbatimin e saj, si dhe një përmbledhje nga Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e realizuar në Kosovë në vitet 2013-2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Në seksionin 2 përshkruhet në hollësi gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e arsimit, ndërsa në seksionin 3 përshkruhet në hollësi gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale. Në seksionin 4 prezantohen rekomandimet e raportit.

1. Konteksti

Të dhënat e regjistrimit të popullsisë në Kosovë në vitin 2011, tregojnë se 8,824 ose 0.5% e popullsisë së përgjithshme janë rom, 15,436 ose 0.9% e popullsisë së përgjithshme janë ashkali dhe 11,524 ose 0.7% e popullsisë së përgjithshme janë egjiptian.¹ Në tabelën 1 janë prezantuar të dhënat e regjistrimit sipas komunave ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian².

Tabela 1. Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian sipas komunave

Komuniteti	Rom	Ashkali	Egjiptian	Gjithsej
Deçan	33	42	393	468
Gjakovë	738	613	5,117	6,468
Glllogoc	0	0	2	2
Gjilan	361	15	1	377
Dragash	3	4	3	10
Istog	39	111	1,544	1,694
Kaçanik	5	1	0	6
Klinë	78	85	934	1,097
Fushë Kosovë	436	3,230	282	3,948
Kamenicë	240	0	0	240
Mitrovicë	528	647	6	1,181

Komuniteti	Rom	Ashkali	Egjiptian	Gjithsej
Lipjan	342	1,812	4	2,158
Novobërdë	63	3	0	66
Obiliq	661	578	27	1,266
Rahovec	84	404	299	787
Pejë	993	143	2,700	3,836
Podujevë	74	680	2	756
Prishtinë	56	557	8	621
Prizren	2,899	1,350	168	4,417
Skenderaj	0	10	1	11
Shtime	23	750	0	773
Shtërpçë	24	1	0	25
Suharekë	41	493	5	539
Ferizaj	204	3,629	24	3,857
Viti	12	14	0	26
Vushtrri	68	143	1	212
Malishevë	26	5	0	31
Mamushë	39	12	0	51
Graçanicë	745	104	3	852
Klllokot	9	0	0	9
Gjithsej	8,824	15,436	11,524	35,784

Në prill të vitit 2017, Qeveria e Kosovës aprovoi Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017 – 2021, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj, duke i identifikuar katër fusha të rëndësishme të veçantë për integrimin e dy komuniteteve, përfshirë fushën e arsimit, banimit, punësimit dhe mirëqenies sociale dhe shëndetësive. Secila nga fushat e identifikuara përmban masa për arritjen e qëllimeve dhe objektivave specifike. Në kuadër të secilit objektiv strategjik, Strategjia trajton edhe tri çështje të ndërlidhura, barazinë gjinore, sigurinë dhe regjistrimin. Masat e kësaj Strategjie janë planifikuar në atë mënyrë që t'i adresojnë çështjet e ndërlidhura në të gjitha fushat e veprimit të Strategjisë.

¹ ASKDATA - <http://askdata.rks-gov.net/PXWeb/pxweb/sq/askdata/?rxid=0b4e087e-8b00-47ba-b7cf-1ea158040712/>
² Po aty.

Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 është dokumenti bazë zhvillimor për forcimin e karakterit multi-etnik dhe multikulturor të shoqërisë kosovare. Strategjia është zhvilluar duke marrë për bazë nevojat e komuniteteve. Që nga fillimi i hartimit të Strategjisë, të tri komunitetet kanë luajtur një rol aktiv në planifikimin e masave, duke identifikuar sfidat me të cilat ballafaqohen dhe nevojat të cilat janë reflektuar në masat gjegjëse.

Vlen të theksohet që Strategjia është aprovuar përfundimisht në prill të vitit 2017, pas 15 muaj vonese. Për shkak të vonesave në hartim dhe aprovim, ajo mbulon periudhën 2017-2021 dhe përfshin vetëm komunitetet rom dhe ashkali të Kosovës. Qëllimi fillestar i kësaj strategjie ishte integrimi i plotë i të tri komuniteteve (rom, ashkali dhe egjiptian) në Kosovë, përmes promovimit efektiv të të drejtave të tyre në fushën e arsimit, punësimit dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë dhe banimit. Gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie, organizata të shumta të shoqërisë civile në Kosovë kanë bashkëpunuar ngushtë me Zyrën për Qeverisje të Mirë dhe ministritë përkatëse, duke përmbyllur kështu me sukses punën në hartimin e draftit përfundimtar, për të cilin ishte arritur konsensusi për aprovim zyrtar nga Qeveria e Kosovës. Në fazën e aprovimit të Strategjisë, Qeveria e Kosovës, në mënyrë krejtësisht të njëanshme dhe pa ndonjë shpjegim, ka hequr komunitetin egjiptian nga masat e parapara në Strategji. Lidhur me këtë çështje, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë kanë shprehur shqetësimin e tyre me një letër drejtuar Qeverisë së Kosovës, në të cilën asnjëherë nuk është dhënë përgjigje.

Një veprim i tillë vlerësohet si shumë i dëmshëm për përfshirjen e komuniteteve joshumicë në përgjithësi dhe për komunitetin egjiptian në veçanti. Komuniteti egjiptian është i dyti për nga madhësia në mesin e këtyre tri komuniteteve në Kosovë, me 11,524 banorë ose 0.7% të popullsisë së Kosovës. Përveç karakteristikave të përbashkëta, të tri komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ndajnë të njëjtat sfida, si në aspektin arsimor ashtu edhe në atë të punësimit, shëndetësisë e banimit, prandaj edhe ndërhyrjet e deritanishme për përmirësimin e pozitës së tyre janë planifikuar dhe zbatuar duke pasur parasysh këto fakte.

Sidoqoftë, zbatimi i Strategjisë në vitin e parë të zbatimit të saj mbetet larg përmbushjes së aktiviteteve të përcaktuara kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit politik, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për monitorimin e progresit, koordinimit jo të mirë të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë shfrytëzimin e pamjaftueshëm të ekspertizës së organizatave relevante të shoqërisë civile.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM), si institucion përgjegjës i ngarkuar për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj. Kjo mungesë e kapaciteteve ka ndikuar negativisht në koordinimin institucional dhe vendosjen e një sistemi të rregullt institucional për monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë në nivel qendror dhe lokal.

Në anën tjetër, komunat nuk kanë krijuar mekanizma për monitorim të zbatimit të Strategjisë, siç është planifikuar në Strategji, si dhe nuk kanë ndarë mjete financiare për vitin 2017. Pengesat në zbatimin e Strategjisë në nivel lokal janë të ndikuara nga vonesa të institucioneve përgjegjëse qendrore në finalizimin e termave të referencës për Komitetet Komunale Vepruese (KKV). KKV janë një mekanizëm i rëndësishëm përmes së cilave parashihet të arrihet koordinimi i aktiviteteve ndërmjet institucioneve lokale dhe qendrore si dhe zbatimi i Planeve Lokale të Veprimit (PLV). Ndërkaq, në aspektin pozitiv vlen të përmenden aktivitetet e realizuara nga organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë mbështetur komunat në hartimin dhe miratimin e PLV-ve.

Qeveria e Kosovës nuk ka linjë specifike të buxhetit për zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë, por në kuadër të buxheteve të ministrive të sektorëve zbatohen aktivitete për zbatimin e Strategjisë. Buxheti i nevojshëm për zbatimin e kësaj Strategjie është llogaritur si pjesë e zhvillimit të planit të veprimit të Strategjisë, ndërsa llogaritja është bërë për tërë periudhën pesëvjeçare të zbatimit të saj. Vlerësimi i buxhetit total për zbatimin e Strategjisë është 15,465,058 EUR, prej të cilave 9,945,838 EUR për fushën e arsimit dhe punësimit dhe mirëqenies sociale, përkatësisht 5,918,850 EUR për arsim, dhe 4,026,988 EUR për punësim dhe mirëqenie sociale. Për vitin 2017, për këto dy fusha kanë qenë të planifikuara 1,313,008 EUR, respektivisht 912,875 EUR për arsim, dhe 400,133 për punësim dhe mirëqenie sociale.

1.1. Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian³

Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS) e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është realizuar në Kosovë në vitet 2013-2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si pjesë e programit global të MICS-it. MICS e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është organizuar paralelisht me MICS-in e Kosovës, me popullatën e përgjithshme të Kosovës 2013-2014. Kjo anketë është realizuar për të siguruar të dhëna të cilësisë së lartë për vlerësimin e gjendjes së fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptianë. Gjetjet e anketës janë një burim i rëndësishëm i informatave për monitorimin e zbatimit të “Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021” si dhe zotimeve tjera që burojnë nga proceset e integritit evropian dhe parimeve të të drejtave të njeriut të përfshira në Kushtetutën e Kosovës.

Anketa ofron të dhëna statistikore të besueshme dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme për zhvillimin e programeve dhe politikave të bazuara në dëshmi. Gjetjet i përkasin periudhës, përveç nëse shprehet ndryshe, nëntor 2013 – mars 2014 të zbatimit të punës në terren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me mbështetjen financiare dhe teknike të Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara (UNICEF).

Sipas të dhënave të gjetura nga Anketa, 60% e popullatës nga këto tri komunitete jetojnë në zonat urbane, ndërsa 40% jetojnë në zonat rurale. Për më tepër, 65% e popullatës janë nën moshën 30 vjeç. Anketa tregon se rritja pozitive e popullatës ka kontribuar që pothuajse gjysma (45%) e popullatës të jenë të moshës 0-17 vjeçare dhe dy të tretat (65%) e popullatës të jenë nën moshën 30 vjeçare. Shkalla e përgjithshme e varësisë, e emërtuar si shkalla e popullatës jo-aktive (moshat 0-14 dhe 65+) ndaj popullatës aktive (mosha 15-64), e shprehur në përqindje është 70%, që nënkupton se për çdo 100 persona aktiv janë 70 persona jo-aktiv.

Anketa po ashtu ka gjetur se shumica (rreth 85%) e fëmijëve të moshës së shkollës fillore ndjekin shkollimin, ndërsa, 15% e fëmijëve janë jashtë shkollës, kjo kryesisht për shkak të shkallës së ulët të vijueshmërisë (68%) për fëmijët e moshës 6 vjeçare, të cilët vlerësohet se e fillojnë shkollën me vonesë, si dhe shkallës së ulët prej 14% të vijueshmërisë së arsimit parashkollor. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët janë jashtë shkollës, rreth 38% i takojnë gjinisë mashkullore, ndërkaq, 25% gjinisë femërore. Për më tepër, fëmijët që jetojnë në ekonomitë familjare ku kryefamiljari i ekonomisë familjare është rom kanë shkallën neto më të ulët të vijueshmërisë (77%), krahasuar me ekonomitë familjare ku kryefamiljari i ekonomisë familjare është egjiptian apo shqiptar (90%). Derisa nuk ka dallime sipas vendbanimeve urbane dhe rurale, ekzistojnë dallime gjinore, ku 60% të meshkujve dhe 76% të femrave vijojnë klasën e parë të shkollës fillore.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës: Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

Më prevalente se në shkollën fillore, vetëm 65% e fëmijëve janë të përfshirë në shkollimin e mesëm të ulët. Ndërkaq, nga një e treta e mbetur, 13% ndjekin shkollën fillore, ndërsa 21% (një në pesë fëmijë) e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët janë plotësisht jashtë shkollës. Numri i vajzave jashtë shkollës është pothuajse 29% në vendbanimet urbane. Vetëm gjysma (52%) e meshkujve të moshës 11 vjeçare janë duke vijuar shkollën e mesme të ulët, prej të cilëve një e treta (34%) janë akoma duke vijuar shkollën fillore. Derisa shkalla neto e vijueshmërisë së shkollës tek meshkujt rritet me moshën, te femrat ndodhë e kundërta. Të dhënat tregojnë se përafërsisht gjysma (44%) e femrave të moshës 14 vjeçare janë jashtë shkollës. Po ashtu, të dhënat tregojnë se egziston një korrelacion pozitiv ndërmjet vijueshmërisë së shkollimit dhe statusit socio-ekonomik. Kjo nënkupton që në ekonomitë familjare më të pasura, proporcioni i atyre që ndjekin arsimin e mesëm të ulët është rreth 89%, derisa te fëmijët që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare është 42%.

Shifrat janë edhe më të theksuara në arsimin e mesëm të lartë, ku më pak se një e treta (30%) e fëmijëve të moshës përkatëse vijnë në shkollën e mesme të lartë, ndërsa shumica (60%) janë plotësisht jashtë shkollës. Sa i përket vijueshmërisë së shkollimit të mesëm të lartë, në vendbanimet rurale vërehen dallime të mëdha gjinore, ku 74% e fëmijëve vajza janë jashtë shkollës, në krahasim me më pak se gjysmën e djemve (45%). Si më lartë, edhe në shkollimin e mesëm të lartë është vërejtur një korrelacion pozitiv me statusin socio-ekonomik, që do të thotë se në familjet me të ardhura më të mëdha, proporcioni i fëmijëve që vijnë në shkollën e mesme të lartë është rreth 48%, përderisa te fëmijët që jetojnë në ekonomitë më të varfëra familjare është vetëm 8%.

Barazia gjinore në shkollën fillore është afër 1.00, që tregon se nuk ka dallime sa i përket vijueshmërisë së shkollës fillore nga vajzat dhe djemtë. Megjithatë, treguesi bie në 0.94 për arsimin e mesëm të ulët, madje edhe më ulët në 0.80 për arsimin e mesëm të lartë, duke treguar dallime të theksuara gjinore. Disavantazhi i femrave është posaçërisht i shprehur në vendbanimet rurale në nivelin e mesëm të lartë (0.41) duke treguar se ka më shumë se dy herë meshkuj se sa femra në sistemin shkollor në atë nivel.

Derisa 22% e fëmijëve të moshës 15-17 vjeçare janë të angazhuar në disa forma të aktiviteteve ekonomike, 3% janë duke bërë detyra të tilla për orë të gjata. Fëmijët e gjinisë mashkullore të moshës 5-11 vjeçare ka më shumë të ngjarë të përfshihen në aktivitete ekonomike (16%) sesa fëmijët e gjinisë femërore të kësaj moshe (4%). E njëjta vlen për fëmijët e moshës 12-14 vjeçare, ndërsa nuk vërehen dallime sipas vendbanimit urban-rural. Në përgjithësi një në çdo gjashtë fëmijë të moshës 5-17 vjeçare (17%) është i/e përfshirë në punë, prej tyre 13% punojnë në kushte të rrezikshme pune. Nga fëmijët të angazhuar në punë, 21% i përkasin gjinisë mashkullore, ndërsa 4% gjinisë femërore.

Një çështje tjetër shqetësuese për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është dukuria e martesave të hershme, e cila është dukshëm më e pranishme te gjinia femërore. Të dhënat tregojnë se 12% e femrave të moshës 15-49 vjeçare janë martuar para moshës 15 vjeçare dhe pothuajse gjysma (43%) e femrave të moshës 20-49 vjeçare janë martuar para moshës 18 vjeçare. Aktualisht, rreth 18% e femrave të moshës 15-19 vjeçare janë të martuara, proporcion ky i lidhur ngushtë me nivelin e vijueshmërisë së arsimimit.

TË DHËNAT KRYESORE TË KËTIJ STUDIMI QË KANË TË BËJNË ME NIVELIN ARSIMOR TË KOMUNITETEVE JANË PREZANTUAR NË VIJIM:

Vijueshmëria e arsimimit në moshë të hershme (parashkollor)

- Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që vijnë në program të arsimimit parashkollor 16.1%.

Kujdesi dhe arsimimi në fëmijëri të hershme

- Vetëm një në gjashtë (16%) fëmijë të moshës 36-59 muajsh ka vijuar një program të organizuar të arsimimit në fëmijëri të hershme, me vetëm një në dhjetë (12%) në vendbanimet rurale ose në mesin e fëmijëve nga ekonomitë më të varfëra familjare. Në nivel vendi kjo përqindje është 13.9%.
- Përqindja e fëmijëve nën moshën 5 vjeçare që kanë tre ose më shumë libra për fëmijë 6%
- Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që në aspektin zhvillimor janë në hap me së paku tri nga katër kriteret vijuese: shkrim-lexim dhe numërim, aspekti fizik, social-emocional dhe të mësuarit 77.2%

Shkalla e shkrim-leximit tek të rinjtë

- Përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeçare që janë në gjendje të lexojnë fjali të shkurtra rreth jetës së përditshme ose që kanë vijuar arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë (a) Femra 72.8 % (98% në nivel të Kosovës) dhe (b) Meshkuj 86.5% (97.6% në nivel të Kosovës).
- Vetëm tri të katërtat (73%) e femrave të reja nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian zotërojnë shkrim-leximin dhe vetëm gjysma (54%) e atyre që kanë deklaruar se shkolla fillore ishte niveli më i lartë i arsimimit të tyre ishin në gjendje të lexonin. Shkalla e shkrim-leximit ishte më e lartë tek meshkujt në 87%, me gjysmën (52%) e meshkujve që kanë deklaruar ngjashëm se shkolla fillore ishte niveli më i lartë i arsimimit të tyre, dhe që në fakt ishin në gjendje të lexonin.

Përgatitja për shkollë

- Përqindja e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore që kanë vijuar arsimin parashkollor gjatë vitit shkollor paraprak 53.9 (75.5 % në nivel të Kosovës).
- Gjysma (54%) e fëmijëve që aktualisht vijnë në klasën e parë të shkollës fillore kanë vijuar nivelin parashkollor në vitin paraprak, dhe më pak se gjysma (48%) në mesin e fëmijëve të 60% të popullatës më të varfër.

Pjesëmarrja në shkollën fillore dhe të mesme

- Përqindja e fëmijëve të moshës shkollore që hyjnë në klasë të parë të shkollës fillore 68.1%
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijojnë arsimin fillor ose të mesëm 85.3% (98% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme që aktualisht vijojnë shkollën e mesme apo arsimin e lartë 53.4%.
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të ulët që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të ulët ose më shumë 65% (95.9% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës së mesme të lartë që aktualisht vijojnë shkollën e mesme të lartë ose më shumë 30.3% (82% në nivel të Kosovës).
- Përqindja e fëmijëve që hyjnë në klasë të parë të shkollës fillore të cilët arrijnë në klasën e fundit 85.4%.
- Shkalla e përfundimit të shkollës fillore 80.5.
- Shkalla e tranzicionit në shkollën e mesme të ulët 91.1.
- Shkalla e tranzicionit në shkollën e mesme të lartë 69.9.
- Indeksi i barazisë gjinore (shkolla fillore) 1.01.
- Indeksi i barazisë gjinore (shkolla e mesme) 0.90.
- Indeksi i barazisë gjinore (shkolla e mesme e ulët) 0.94.
- Indeksi i barazisë gjinore (shkolla e mesme e lartë) 0.80.

Fëmijët në punë

- Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare të cilët janë të angazhuar në punë - 16.6% (10.7% në nivel të Kosovës).

Martetat e hershme

- Përqindja e individëve të martuar para moshës 15 vjeçare, (a) femra 11.6% dhe (b) meshkuj 1.0%
- Përqindja e individëve të martuar para moshës 18 vjeçare, (a) femra 42.7% dhe (b) meshkuj 13.5%.
- Të rinjtë e moshës 15-19 vjeçare që aktualisht janë të martuar ose në bashkëjetesë - Përqindja e të rinjve të moshës 15-19 vjeçare që janë të martuar ose në bashkëjetesë (a) femra 17.8% dhe (b) meshkuj 3.8%.

ARSIMI



2. Arsimi

Arsimi është sektor kyç zhvillimor për integrimin dhe përfshirjen sociale të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe domosdoshmëri për luftimin e varfërisë, mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rrezikshme, dhe promovimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Fatkeqësisht, në Kosovë, shkollimi i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ende nuk konsiderohet si vlerë e rëndësishme dhe nuk është prioriteti i shumicës së familjeve të këtyre komuniteteve.

Fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian fillojnë klasën e parë në moshën 6 vjeçare, shkollën e mesme të ulët në moshën 11 vjeçare dhe të mesme të lartë në moshën 15 vjeçare. Në shkollën fillore, klasat referohen si klasa e 1-rë deri në klasën e 5-të. Për shkollën e mesme të ulët klasat referohen si klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, dhe për shkollën e mesme të lartë klasat referohen si klasa e 10-të deri në klasën e 12-të.

Sipas të dhënave të vitit 2017 nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin (SMIA), numri i fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë nga niveli parashkollor deri në nivelin e mesëm të lartë është 6,666 fëmijë dhe përbën 1.8% të numrit të përgjithshëm të fëmijëve në arsimin parauniversitar (375,507). Ndërsa, numri i personelit arsimor rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar është gjithsej 14 mësime nga gjithsej 23,202 pjesëtarë të personelit arsimor në Kosovë.

Pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin e arsimit ka shënuar përparim të dukshëm në 17 vitet e fundit, veçanërisht në arsimin fillor (klasat 1-5) ku pjesëmarrja ka tejkaluar 85%⁴. Megjithatë, krahasuar me mesataren e Kosovës, pjesëmarrja nuk është ende në nivel të kënaqshëm dhe shkon duke u zvogëluar dukshëm në nivelet më të larta të sistemit të arsimit. Kështu, në arsimin e mesëm të ulët (klasat 5-9) marrin pjesë vetëm 65%⁵ të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të grup-moshës 11-14, ndërsa në arsimin e mesëm të lartë (klasat 9-12) pjesëmarrja e tyre zvogëlohet në 30.3%⁶. Të dhënat flasin për një përfaqësim të barabartë gjinor në nivelin fillor, por gjendja përkeqësohet në nivelet më të larta të sistemit të arsimit.

Numri i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parashkollor, në vitin shkollor 2017/18 ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak, ndërsa pjesëmarrja në arsimin e detyrueshëm dhe atij të mesëm të lartë ka ndjekur një trend relativisht të stabilizuar (Tabela 2). Megjithatë, nga këto të dhëna është e pamundur të vlerësohet progresi i pjesëmarrjes së këtyre komuniteteve në sistemin arsimor, pasi mungojnë të dhënat referente për popullsinë. Një vlerësim i tillë mund të bëhet vetëm përmes anketës specifike të realizuar në vitin 2014⁷.

4 Anketa e grupimeve të treguesve të shumëfishitë 2013-2014, Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (MICS), Raporti final, ASK, Prishtinë 2014, f. VII.

5 Po aty.

6 Po aty.

7 Po aty.

Tabela 2. Fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar

Nxënësit	2015/16	2016/17	2017/18
Niveli parashkollor	373	601	424
Klasat 1-9	5,524	5,544	5,693
Klasat 10-12	431	413	549

Burimi: Statistikat e MASHT për vitet shkollore 2015/16-2017/18

Shkaqet e pjesëmarrjes së ulët të fëmijëve të komunitetit rom, ashkali egjiptian në sistemin arsimor dallojnë sipas niveleve. Në edukimin parashkollor publik mundësitë janë të kufizuara, ndërsa në institucionet parashkollore private kosto është e lartë, ndërkohë që numri i qendrave mësimore është i kufizuar dhe nuk kanë mbështetje institucionale. Edukimi parafillor ofrohet falas, në shkolla publike, por, përsëri shkalla e regjistrimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është më e ulët sesa në nivel të Kosovës, e që mund të jetë çështje e vetëdijesimit. Ndërkaq, zvogëlimi i pjesëmarrjes në arsimin e mesëm të ulët, e sidomos në arsimin e mesëm të lartë, mund të lidhet me faktorët ekonomikë, pikërisht me pamundësinë e familjeve që t'i mbulojnë shpenzimet e ndërlidhura me shkollimin e fëmijëve të tyre, duke hequr dorë nga të ardhurat që ata mund t'i sjellin familjes në këtë periudhë të jetës së tyre. Shumë fëmijë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike detyrohen të ndërpresin shkollën për t'u bërë krah pune për familjet e tyre. Megjithatë, është pozitive fakti që një numër i familjeve të këtyre komuniteteve që kanë fëmijë duke u shkolluar pranojnë ndihma të ndryshme si ndihmesë për shkollimin e fëmijëve të tyre.

Strategjia parashih hartimin e rregullores për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel parashkollor dhe shkollat e mesme të larta, gjë që nuk është realizuar gjatë vitit 2017. Megjithatë, Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Shtimes janë shembuj të mirë, ku përkundër mungesës së rregullores organizohen aktivitete të ndryshme për të lehtësuar kushtet e regjistrimit në shkollë të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, siç janë: mbledhja me prindër në qendrat e komuniteteve, angazhimi i aktivistëve të komuniteteve, apo vizitave në shtëpi nga anëtarët e Ekipeve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obligueshëm (EPMPB) në nivel komune dhe në nivel shkolle.

Fëmijët në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë shkallë të lartë të braktisjes së shkollës, në veçanti vajzat, si dhe regjistrim të vonshëm pas moshës së zakonshme të regjistrimit fillestar prej gjashtë vjeç. Nga diskutimet me përfaqësues nga komunitetet, një sërë faktorësh kontribuojnë në këtë situatë, përfshirë shkallën ekstreme të varfërisë ndër këto tri komunitete, nivelin e ulët të edukimit dhe vetëdijes së ulët mbi rëndësinë e shkollimit, shqetësimin dhe diskriminimin në shkolla, si dhe mungesën e mësuesve me origjinë rom, ashkali dhe egjiptiane.


Për më tepër, një numër i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian nuk regjistrohen ose e braktisin shkollën për arsye se familjet e tyre migrojnë gjatë vitit shkollor, apo largohen nga vendi dhe, pas kthimit, është e vështirë t'i rikthehen arsimit. Ndonjëherë arsye për këtë është mungesa e dokumenteve nga shkollat në vendet tjera, si dhe vështirësitë me njohjen e tyre.

Nxënësit e të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (kryesisht të komunitetit rom) nga komuna e Mitrovicës dhe komuna e Graçanicës ballafaqohen edhe me disa probleme shtesë që janë karakteristike vetëm për këto dy komuna. Këta nxënës në këto dy komuna vijojnë shkollimin në shkollat serbe, pra dhe në gjuhën serbe, të cilat funksionojnë në Kosovë me sistem paralel nga Serbia dhe që nuk është në përputhje me sistemin arsimor të Kosovës. Si rezultat i kësaj, këta nxënës kanë probleme dhe vështirësi për t'u regjistruar në shkollimin e mesëm të lartë ose në universitete në gjuhën shqipe, edhe për shkak se nuk e njohin gjuhën shqipe edhe për shkak se ndodh që për shkak të mospërputhjes së sistemeve, nuk ju pranohen diplomat. Ndërsa në anën tjetër kanë mundësi shumë më të kufizuara për t'u regjistruar në shkollimin e mesëm të lartë dhe në universitete në gjuhën serbe, sepse nuk kanë shumë mundësi zgjedhjeje, apo nuk kanë fare.

Nëse e krahasojmë nivelin e arsimit të pjesëtarëve të përkatësive të ndryshme etnike në Kosovë, vërehet një dallim i madh sa i përket nivelit të arsimit ndërmjet pjesëtarëve të përkatësive etnike shqiptare dhe atyre të përkatësive etnike jo-shumicë: rom, ashkali dhe egjiptian. Përderisa në vitin 2013, 44.2% e popullatës shqiptare, e moshës 15-vjeçare dhe më lartë, ka pasur së paku një arsimim të mesëm të lartë, përqindja te romët, ashkalitë dhe egjiptianët, e të njëjtës grup-moshë, ka qenë dukshëm më e ulët, 10.8% për romët, 8.7% ashkalitë dhe 9.95% egjiptianët të dhëna të cilat mund të shihen më hollësisht në tabelën 3 më poshtë:⁸

8 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Karakteristikat Arsimore të Popullatës së Kosovës, tetor 2013, fq. 22.

Tabela 3. Popullata e moshës 15 vjeçare e më lartë, niveli arsimor sipas përkatësisë etnike



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013

Përqendrimi në rritjen e përfshirjes nuk është shoqëruar gjithnjë edhe me aktivitete që ndikojnë në ngritjen e cilësisë së rezultateve të të nxënësve. SMIA nuk përmban informata lidhur me performancën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në testet kombëtare, në raport me mesataren e vendit dhe komunën përkatëse. Përkundër mungesës së të dhënave të sakta, bazuar nga vlerësimet e fokus grupeve të organizuara, vlerësohet se në mesatare të përgjithshme, nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë sukses më të dobët se nxënësit e komuniteteve të tjera shumicë. Gati të gjithë faktorët e arsyet që ndikojnë në mosregjistrimin, në mungesën e vijimit dhe në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e këtyre komuniteteve janë edhe faktorë e arsye për këtë sukses më të dobët. Por, përveç atyre, mund të numërohen edhe disa faktorë dhe arsye për këtë sukses më të dobët, si:

- ✓ Mosvijimi në edukimin parashkollor dhe në klasën parafilllore bën që këta nxënës të jenë më pak të përgatitur për shkollën fillore se sa moshatarët tjerë të tyre dhe kjo reflekton në sukses më të dobët që përcillet pastaj nivel pas niveli gjatë gjithë shkollimit. Në këtë fazë fitohen shkathtësitë e para-leximit dhe të para-numeracionit që janë me rëndësi për fillim të mbarë të shkollimit të obligueshëm.
- ✓ Mosvijueshmëria e rregullt (mungesat) gjatë shkollimit gjithashtu ndikojnë në suksesin më të dobët të këtyre nxënësve.
- ✓ Mungesa e orëve shtesë dhe e mësimi plotësues nëpër shkolla me këta nxënës ndikojnë në suksesin më të dobët të këtyre nxënësve.
- ✓ Shkalla e lartë e analfabetizmit të prindërve të këtyre nxënësve ndikon në suksesin e dobët, sepse prindërit nuk mund të punojnë me nxënësit e tyre në shtëpi për t'i ndihmuar rreth detyrave shkollore.
- ✓ Kushtet e vështira ekonomike të familjes ndikojnë në suksesin më të dobët të këtyre nxënësve, sepse familjet nuk mund të ofrojnë materiale mësimore e kushte stimuluese për fëmijët e vet.

Faktorë tjerë të cilën pengojnë suksesin e nxënësve të këtyre komuniteteve janë: largësia e shkollës nga vendbanimi ku ata jetojnë si dhe angazhimi i fëmijëve në punë për sigurimin e ekzistencës së familjes. Për më tepër, sjellja jo e mirë e nxënësve të komuniteteve tjera dhe e mësimdhënësve në raport me nxënësit e këtyre komuniteteve raportohet që të jetë si njëra nga vështirësitë për suksesin e këtyre nxënësve gjatë shkollimit të tyre. Ndërkaq, tek fëmijët rom shpesh paraqitet problemi i mosnjohjes së gjuhës së shkollimit në masë të mjaftueshme për të treguar performancë të mirë. Mësimi i lëndës së gjuhës romë ofrohet në të gjitha komunat e Kosovës, me përjashtim të Komunës së Prizrenit, ku organizohet në 4 shkolla dhe është e punësuar vetëm një mësimdhënëse.

Një aspekt i rëndësishëm i pjesëmarrjes konsiderohet të jetë ngritja e rezultateve të të nxënësve, pasi ndërprerja e shkollimit është, shpesh, pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së suksesit në mësim.

Pjesa më e madhe e programeve për vetëdijesimin e prindërve lidhur me rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe vetëdijesimin e tyre për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, ende organizohet vetëm nga organizatat e shoqërisë civile. Gjatë vitit 2017, përkundër aktiviteteve të parapara në Strategji, nuk është raportuar ndonjë aktivitet për ndërgjegjësimin e këtyre komuniteteve i organizuar nga autoritetet qendrore dhe lokale.

Bazuar nga vlerësimet e fokus grupeve të organizuara, në përgjithësi, vlerësohet se fëmijët dhe nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk diskriminohen në institucionet edukativo-arsimore. Megjithatë, në raste të caktuara raportohet se ekziston një diskriminim pasiv e “i fshehur” ndaj këtyre nxënësve nga ana e mësimdhënësve dhe bashkëmoshatarëve të tyre. Kjo vërehet nga fakti se nxënësit e këtyre komuniteteve ulen në bankat e fundit në klasë dhe ka raste kur nxënësit e komuniteteve tjera nuk pranojnë të ulen në bankë me nxënësit e këtyre komuniteteve.

2.1. Pjesëmarrja në edukimin parashkollor dhe parafillor

Fëmijëria e hershme është një fazë e rëndësishme e jetës në aspektin e zhvillimit fizik, intelektual, emocional dhe social të fëmijës. Rritja e aftësive mendore dhe fizike përparon në një masë të madhe dhe një përqindje shumë e lartë e të mësuarit zhvillohet nga lindja deri në moshën gjashtëvjeçare. Në Kosovë, edukimi parashkollor organizohet përmes kopshteve publike dhe private të cilat kanë një tarifë të veçantë që duhet paguar. Duke pasur parasysh varfërinë e skajshme me të cilën përballen komunitet rom, ashkali dhe egjiptian, kjo tarifë është pengesë kryesore për përfshirjen e fëmijëve të tyre në sistemin e edukimit parashkollor. Po ashtu, ekziston një nivel shumë i ulët i ndërgjegjësimit të këtyre komuniteteve, sa i përket njohjes së rolit dhe rëndësisë së edukimit në këtë fazë të zhvillimit të fëmijëve.

Rëndësia e regjistrimit të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në klasa parafillore, si një klasë përgatitore për fëmijët e moshës 5 – 6 vjeçare para se të fillojnë arsimin fillor është po ashtu thelbësore. Kjo përgatitje ofron mundësinë që këta fëmijë të tejkalojnë barrierat gjuhësore dhe kulturore, të socializohen dhe të marrin përgatitje të caktuara për qasjen e tyre në nivelin fillor të arsimit. Klasat përgatitore janë klasa të organizuara në kuadër të shkollave fillore, janë pa pagesë dhe në të shumtën e rasteve realizohen me mbështetjen e ofruar nga organizatat e shoqërisë civile për institucionet arsimore në nivel lokal.

Sipas statistikave të MASHT, në vitin shkollor 2017/18, numri i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parashkollor (0-6 vjeç) në kopshte është shtuar për 35 fëmijë në raport me vitin shkollor 2016/17, kur vetëm 1 fëmijë rom vijonte edukimin parashkollor (Tabela 4). Numri i përgjithshëm i fëmijëve në edukimin parashkollor (0-5 vjeç) dhe arsimin parafillor (5-6 vjeç) në institucionet publike dhe private, përfshirë institucionet serbe në vitin shkollor 2016/17 ishte 29,473⁹.

Tabela 4. Numri i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parashkollor (3-6 vjeç) sipas gjinisë dhe komunave në vitin shkollor 2017/18

Komuna	Klasë	Ashkali		Rom		Egjiptian		Gjithsej	
		M	Gj	M	F	Gj	F		Gj
Gjakova	Grupi 3-4	0	0	1	0	1	0	0	1
	Grupi 4-5	0	0	1	0	1	0	0	1
	Grupi 5-6 Parashkollor (Çerdhe)	0	0	14	2	16	7	7	23
	Gjithsej	0	0	16	2	18	7	7	25
Kamenica		M	T	M	F	T	F	T	
	Groupi 4-5	0	0	4	2	6	0	0	6
	Gjithsej	0	0	4	2	6	0	0	6
Mitrovicë Jugore		M	T	M	F	T	F	T	
	Groupi 5-6 Parashkollor (Çerdhe)	1	1	0	0	0	0	0	1
	Gjithsej	1	1	0	0	0	0	0	1
Prizren		M	T	M	F	T	F	T	
	Groupi 3-4	0	0	0	1	1	0	0	1
	Groupi 4-5	0	0	1	0	1	0	0	1
	Groupi 5-6 Parashkollor (Çerdhe)	0	0	1	1	2	0	0	2
	Gjithsej	0	0	2	2	4	0	0	4
Gjithsej	1	1	22	6	28	7	7	36	

Burimi: Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2017/18

Megjithatë, të dhënat lidhur me pjesëmarrjen në edukimin parashkollor nuk mund të merren si refleksion i gjendjes reale, meqenëse këto të dhëna nuk përfshijnë fëmijët që vijnë në programet në Qendrat Mësimore që menaxhohen nga organizata të shumta të shoqërisë civile. Shumica e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e vijnë në edukimin parashkollor në qendrat mësimore, që janë kryesisht në vendbanimet e tyre dhe funksionojnë kryesisht për adresimin e nevojave të tyre.

Në shumicën e komunave në Kosovë mungojnë klasa për arsimim parafillorë si dhe nuk ekzistojnë rregullore për lehtësimin e kushteve për regjistrim dhe vijim të programit parashkollorë nga ana e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian. Në Fushë Kosovë ekziston vetëm një çerdhe publike për të cilën qytetarët duhet të paguajnë rreth 50 euro në muaj dhe të dy prindërit duhet të jenë të punësuar në mënyrë që të plotësojnë kushtin për regjistrim. Të dy kushtet paraqesin vështirësi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, pasi që ata përballen me situatë të veshtirë ekonomike dhe nivel të lartë të papunësisë, ku mbi 95% të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë në punë.

Përkundër që në Strategji parashihet stimulimi i vijimit të edukimit parashkollor, përmes mbështetjes së programeve parashkollore me bazë në komunitet dhe subvencionimit të pagesave për regjistrim në institucione parashkollore publike për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian, këto masa nuk janë ndërmarrë nga Qeveria gjatë vitit 2017. Nga informatat në terren, nuk është raportuar ndonjë rast i hapjes së klasave parafillore në shkollat ku gravitojnë fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që të zhvillohen përgatitjet e duhura për përfshirjen e tyre në arsimin e obligueshëm. Po ashtu, niveli i përfshirjes së edukatorëve rom, ashkali dhe egjiptian është jashtëzakonisht i ulët.

Sa i përket përfshirjes së fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në nivelin parafillorë (5-6 vjeç) në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, situata është shqetësuese meqenëse të dhënat nga SMIA për vitin 2017/2018 tregojnë se numri i fëmijëve në arsimin parafillor është 388 fëmijë (Tabela 5), që paraqet një rënie prej 35% në raport me vitin shkollor paraprak 2016/17, kur ishin gjithsej 597 fëmijë, prej të cilëve 289 rom, 175 ashkali dhe 133 egjiptian.

Tabela 5. Numri i fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor (5-6 vjeç) sipas gjinisë dhe komunave në vitin shkollor 2017/18

Komuna	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej
	M	F	T	M	F	T	M	F	T	
Deçan	2	2	4	0	0	0	1	1	2	6
Gjakovë	26	22	48	5	11	16	8	4	12	76
Istog	5	4	9	1	0	1	5	6	11	21
Klinë	4	5	9	2	2	4	0	2	2	15
Kamenicë	0	0	0	5	8	13	0	0	0	13
Mitrovicë Jugore	1	0	1	1	0	1	0	0	0	2
Lipjan	19	17	36	2	1	3	0	0	0	39
Obiliq	9	12	21	0	0	0	0	0	0	21
Rahovec	3	1	4	2	4	6	1	2	3	13
Pejë	2	2	4	10	9	19	2	8	10	33
Podujevë	6	5	11	1	1	2	0	0	0	13
Prishtinë	5	0	5	0	1	1	0	0	0	6
Prizren	8	7	15	7	12	19	6	2	8	42
Shtime	10	7	17	0	0	0	0	0	0	17
Suharekë	4	4	8	0	0	0	0	0	0	8
Ferizaj	35	28	63	0	0	0	0	0	0	63
Gjithsej	139	116	255	36	49	85	23	25	48	388

Burimi: Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2017/18

2.2. Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe të mesëm

Në vitin shkollor 2017/18, numri i nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është 5,693 (Tabela 6), që paraqet një rritje prej 2.7% në raport me vitin shkollor 2016/17, ku ishin 5,542 fëmijë, prej të cilëve 1,276 rom, 3,398 ashkali dhe 868 egjiptian. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në institucionet publike dhe private, përfshirë institucionet serbe në vitin shkollor 2016/17 ishte 255,093.¹⁰

¹⁰ Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2016/17.

Tabela 6. Number of Roma, Ashkali and Egyptian students in primary and lower secondary education by gender and municipality in school year 2017/18

Municipality	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej
	M	F	T	M	F	T	M	F	T	
Deçan	33	26	59	2	0	2	12	15	27	88
Gjakova	284	240	524	340	289	629	89	85	174	1327
Gjilan	0	0	0	0	1	1	0	0	0	1
Istog	32	29	61	10	9	19	142	130	272	352
Klina	88	77	165	27	35	62	4	8	12	239
Fushë Kosova	272	223	495	3	5	8	15	11	26	529
Kamenica	0	0	0	81	77	158	0	0	0	158
South Mitrovica	27	25	52	0	4	4	0	0	0	56
Lipjan	164	190	354	26	18	44	0	0	0	398
Obiliq	73	63	136	0	0	0	0	0	0	136
Rahovec	8	17	25	37	33	70	23	15	38	133
Peja	27	16	43	173	165	338	84	91	175	556
Podujeva	67	58	125	3	4	7	0	0	0	132
Prishtina	31	34	65	2	4	6	2	1	3	74
Prizren	124	120	244	191	182	373	12	2	14	631
Skënderaj	4	0	4	0	0	0	0	0	0	4
Shtime	71	58	129	0	2	2	0	0	0	131
Suhareka	53	51	104	3	3	6	0	0	0	110
Ferizaj	315	306	621	1	0	1	0	0	0	622
Viti	0	2	2	0	0	0	0	0	0	2
Vushtrri	4	4	8	0	0	0	0	1	1	9
Malisheva	0	2	2	3	0	3	0	0	0	5
Gjithsej	1677	1541	3218	902	831	1733	383	359	742	5693

Source: MEST Statistics for school year 2017/18

Bazuar nga vlerësimet e fokus grupeve të organizuara, vijueshmëria e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollimin fillor (klasët 1-5) konsiderohet të jetë mjaft e lartë. Nxënësit në këtë nivel shkollimi bëjnë më pak mungesa dhe ka raste më të rralla të braktisjes së shkollimit në këtë nivel. Në anën tjetër, vijueshmëria e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollimin e mesëm të ulët (klasët 6-9) konsiderohet të jetë më e ulët se në nivelin fillor, qoftë në kuptimin e mungesave të nxënësve qoftë në kuptimin e braktisjes së shkollimit. Ky fenomen vlerësohet se është i lidhur kryesisht me gjendjen e rëndë ekonomike të këtyre komuniteteve, por ndodh edhe për arsye e faktorë të tjerë, si:

- ✓ Për shkak të gjendjes së rëndë financiare shumë prindër i ndalin fëmijët (kryesisht fëmijët meshkuj) nga shkolla dhe i detyrojnë të punojnë ose të kërkojnë lëmshë.
- ✓ Për shkak të gjendjes së rëndë financiare shumë prindër i ndalin fëmijët (kryesisht fëmijët femra) nga shkolla për t'u kujdesuar për familjen dhe për t'i bërë punët e shtëpisë.
- ✓ Nxënësit e këtij niveli janë më të rritur, prandaj bëjnë mungesa ose e braktisin shkollimin kur nuk kanë mjetet e nevojshme shkollore dhe veshmbathje të duhur, meqë ndihen më inferiorë në raport me nxënësit tjerë. Problemi me veshmbathje reflekton në mungesa të nxënësve sidomos gjatë periudhës së dimrit.
- ✓ Mësimdhënësit lëndorë nuk janë aq të kujdesshëm ndaj këtyre nxënësve sa mësimdhënësit klasorë (të shkollës fillore). Gjithashtu, vlerësimi (notimi) gjatë shkollës së mesme të ulët është më i ashpër se sa gjatë shkollimit fillor, prandaj meqë nxënësit e këtyre komuniteteve kanë sukses më të dobët dhe mund të ndodh që ta përsërisin vitin, kjo ndikon në humbjen e vetëbesimit të nxënësit dhe demotivimin e tyre për vijimin e shkollimit.

MASHT ofron tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit në arsimin e obligueshëm (klasat 1-9). Gjatë vitit 2016, rreth 5414 nxënës të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar tekste dhe materiale tjera mësimore falas.

Ngjajshëm, në vitin shkollor 2017/18, numri i nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë është 549 (Tabela 7), që paraqet një rritje prej 33% në raport me vitin shkollor 2016/17, ku ishin 412 nxënës, prej të cilëve 259 rom, 2 ashkali dhe 151 egjiptian. Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në institucionet publike dhe private, përfshirë institucionet serbe në vitin shkollor 2016/17 ishte 90,941¹¹.

Tabela 7. Numri i nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë sipas gjinisë dhe komunave në vitin shkollor 2017/18

Komuna	Ashkali			Rom			Egjiptian			Gjithsej
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	
Gjakovë	15	35	50	49	15	64	9	7	16	130
Istog	2	0	2	0	0	0	37	5	42	44
Klinë	7	0	7	2	2	4	10	4	14	25
Fushë Kosovë	18	20	38	0	1	1	9	12	21	60
Kamenicë	0	0	0	10	11	21	0	0	0	21
Mitrovicë Jugore	0	0	0	1	0	1	0	0	0	1
Lipjan	29	12	41	0	0	0	0	0	0	41
Obiliq	5	2	7	0	0	0	0	0	0	7
Rahovec	1	1	2	0	0	0	0	0	0	2
Pejë	1	1	2	1	2	3	28	19	47	52
Podujevë	10	11	21	0	0	0	0	0	0	21
Prishtinë	0	0	0	0	1	1	0	0	0	1
Prizren	0	5	5	31	23	54	2	0	2	61
Shtime	2	2	4	5	0	5	0	0	0	9
Ferizaj	44	27	71	1	0	1	0	0	0	72
Malishevë	1	0	1	1	0	1	0	0	0	2
Gjithsej	135	116	251	101	55	156	95	47	142	549

Burimi: Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2017/18

11 Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2016/17.

Bazuar nga vlerësimet e fokus grupeve të organizuara, vijueshmëria e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollimin e mesëm të lartë (klasat 10-12) konsiderohet të jetë mjaft i ulët, meqë vetëm një numër i vogël i nxënësve të këtyre komuniteteve regjistrohen në këtë nivel shkollimi. Pothuajse të gjitha shkaqet e arsytet që shpijnë në mosvijimin dhe braktisjen e shkollimit të mesëm të ulët janë të vlefshme edhe për shkollimin e mesëm të lartë, veçse për këtë të fundit ka edhe shkaqe dhe arsye të tjera shtesë përse nxënësit e këtyre komuniteteve nuk regjistrohen, si:

- ✓ Shpenzimet e shkollimit të mesëm të lartë janë më të larta për shkak se duhet transport, veshmbathje dhe tekste shkollore që duhet të mbulohen nga vet familja dhe kjo është e papërbalueshme për shumë familje të këtyre komuniteteve.
- ✓ Një numër i nxënësve (kryesisht të gjinisë femërore) nuk e vijojnë këtë nivel shkollimi për shkak të martesave të hershme.
- ✓ Një numër i nxënësve nuk e vijojnë këtë nivel shkollimi për shkak se orientohen për të mësuar zanate të caktuara që kërkojnë më pak përgatitje dhe ju ofrojnë mundësi për punësim më të shpejtë (p.sh. frizer/e, rrobaqepës/e, etj.).
- ✓ Për shkak se nxënësit e këtyre komuniteteve kanë sukses kryesisht më të dobët gjatë shkollimit paraprak, e kanë të vështirë që të regjistrohen në drejtime që ju pëlqejnë (kryesisht në gjimnaze), prandaj detyrohen të regjistrohen vetëm në drejtime të caktuara të shkollave profesionale ku nuk ka shumë konkurrencë. Si rezultat i kësaj ose nuk regjistrohen fare ose e braktisin shkollimin pasi të regjistrohen.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me partnerët zhvillimor ndërkombëtarë dhe organizatat jo-qeveritare (KFOS, KEC, HEKS, VoRAE, REF), kanë themeluar një program të bursave për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, që vijojnë shkollimin e mesëm të lartë. Qëllimi i këtij programi është nxitja e nxënësve të këtyre komuniteteve për vijimin dhe përfundimin e shkollimit të mesëm të lartë. Shuma e bursës të cilën nxënësit e marrin është 30 euro për muaj, respektivisht 300 euro për vit, shumë e cila nuk është mjaftueshme për të gjithë fëmijët, në veçanti për nxënësit të cilët udhëtojnë nga vendet rurale në qytete për të vijuar mësimin. Në vitin 2017 në nivel vendi janë ofruar rreth 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, KEC në kuadër të projektit “EU SIMRAES II” zbaton programin e mentorimit, program ndihmës që realizohet nëpërmjet mentorëve (profesorë të shkollave të mesme) për të monitoruar vijueshmërinë, suksesin dhe për të parandaluar braktisjet e mundshme nga ana e nxënësve. Si rregull, pjesë e programit të mentorimit janë nxënësit me sukses më të dobët dhe ata me rrezik më të lartë për braktisje të shkollimit.

Në vitin shkollor 2017/18 janë vetëm 14 mësimdhënës rom, ashkali dhe egjiptian të angazhuar në arsimin parauniversitar (Tabela 8), ndërsa, numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në arsimin parauniversitar, në vitin shkollor 2016/17 ishte 23,202, prej të cilëve në nivelin parashkollor 535 edukatorë, në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët 17,410 mësimdhënës dhe në nivelin e mesëm të lartë 5,257 mësimdhënës.¹²

12 Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2016/17.

Tabela 8. Numri i mësimdhënësve rom, ashkali dhe egjiptian sipas niveleve të shkollimit dhe gjinisë në vitin shkollor 2017/18

Niveli	Rom			Egjiptian			Ashkali			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsim fillor dhe i mesëm i ulët	2	3	5	1	3	4	2	0	2	5	6	11
Arsim i mesëm i lartë	0	0	0	0	1	1	2	0	2	2	1	3

Burimi: Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2017/18

Në anën tjetër, në shumicën e qendrave mësimore që menaxhohen nga organizatat e shoqërisë civile personeli i angazhuar është nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Si shembull në këtë aspekt është projekti i financuar nga BE-ja “EU SIMRAES II” që zbatohet nga KEC, i cili në shtatë komuna në të cilat zbatohet, ka të angazhuar rreth 15 fasilitatorë dhe 90 tutorë nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Një praktikë e njëjtë zbatohet edhe nga organizata të tjera të shoqërisë civile si KFOS dhe BSFK, ku në shumicën e vendeve ku ato janë angazhuara personeli i cili punon me nxënës vjen kryesisht nga vet komuniteti rom, ashkali apo egjiptian. Vlen të theksohet se personeli në qendra mësimore zakonisht nuk ka thirrje akademike, meqenëse natyra e asistencës që u jepet fëmijëve është jo-formale.

Një fakt pozitiv për përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollim është trajnimi i një numri të konsiderueshëm të mësimdhënësve në programe të ndryshme për gjithëpërfshirje, drejtësi shoqërore, diversitet etnik, kulturor, fetar, gjuhësor, e tjera. Këto trajnime janë organizuar kryesisht nga organizata qeveritare ndërkombëtare dhe lokale. Në këtë drejtim, Projekti “EU-SIMRAES II” ka trajnuar 286 pjesëmarrës në programin e trajnimit “Edukimi për Drejtësi Shoqërore” ku përfshihen mësimdhënësit, prindërit dhe stafi i qendrave mësimore. Prej tyre mbi 170 pjesëmarrës janë mësimdhënës nga shkollat ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Po ashtu, projekti “Prospect Plus” ka trajnuar për gjithëpërfshirje rreth 80 mësimdhënës dhe prindër në komunën e Suharekës, dhe rreth 80 të tjerë në komunën e Pejës.

2.3. Braktisja e shkollimit

Përveç nivelit të ulët arsimor, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, gjithashtu ballafaqohen me një shkallë të lartë të braktisjes së shkollimit. Ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollimit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është niveli i ulët i arsimimit të prindërve të tyre. Rrjedhimisht, nuk e vlerësojnë rëndësinë e shkollimit dhe si pasojë ndikojnë te fëmijët që të braktisin atë. Krahas kësaj, ka shumë faktorë të tjerë, socialë dhe ekonomikë që poashtu ndikojnë në braktisje, përfshirë nivelin e lartë të papunësisë në mesin e këtyre komuniteteve, gjendjen e rëndë ekonomike në shumë nga këto familje, fenomeni i martesave të hershme në mesin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, përsëritja e vitit shkollor për shkak të suksesit të dobët, qasja në infrastrukturë përkatëse deri në shkollë (rruga, ndriçimi dhe mungesa e transportit), e të tjera.

Arsye tjetër e braktisjes është migrimi i familjeve për arsye ekonomike dhe kthimi prapa në Kosovë, kryesisht për shkak të mosnjohjes së gjuhës apo mospërshtatjes me mjedis të ri dhe që rrjedhimisht ndikon në përfshirjen dhe në arritjet e këtyre fëmijëve në arsim. Raportohet se një numër i madh i familjeve rom, ashkalinje dhe egjiptiane kanë emigruar jashtë vendit, sidomos gjatë valës së fundit të migrimëve në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015.

Për më tepër, fëmijët e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian jo rrallë përballen me diskriminim në shkolla nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit e tyre. Fëmijët e këtyre komuniteteve dhe prindërit e tyre megjithëse ballafaqohen me diskriminim strukturor nga institucionet e arsimit, veçanërisht në nivel shkolle dhe në klasë, hezitojnë të flasin haptas për këtë dukuri dhe zbrapsen duke u frikësuar nga pasojat e mundshme në rast të raportimit.

Përkundër që MASHT ka disa vite që shfrytëzon një sistem të avancuar për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave në arsim, ende nuk ka statistika të besueshme për normën e braktisjes. Sipas të dhënave për vitin shkollor 2016/17, 119 nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë braktisur shkollimin (Tabela 9).

Tabela 9. Nxënës braktisës sipas gjinisë në vitin shkollor 2016/17

Klasë	Ashkali			Rom			Egjiptian			Tri komunitetet		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Klasat 1-9	40	21	61	4	3	7	19	13	32	63	37	100
Klasat 10-12	0	0	0	8	11	19	0	0	0	8	11	19
Gjithsej	40	21	61	12	14	26	19	13	32	71	48	119

Burimi: Statistikat e MASHT për vitin shkollor 2016/17

Në vitin 2012, MASHT ka nxjerrë Udhëzim Administrativ duke i dhënë institucioneve arsimore në nivel komunal përgjegjësi për themelimin dhe funksionalizimin e “Ekipëve për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Arsimin e Obligueshëm” (EPRMB). Duke qenë të obligueshme në nivel shkolle dhe komune, EPRMB-të synojnë të bashkërendojnë veprimet për t’i trajtuar braktisjet dhe për ta luftuar regjistrimin e ulët. Formimi i EPRMB është një hap i rëndësishëm për te iu siguruar fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të drejtën për edukim, dhe për t’i përkrahur ata në procesin mësimor. Gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave për këtë raport, është vërejtur që në shumicën e komunave të Kosovës janë themeluar EPRMB në nivel komunal dhe shkolle. Mirëpo, shumica e EPRMB nuk janë funksionale, dhe nuk ka monitorim të punës së tyre. Në komunën e Fushë Kosovës¹³ e cila ka një numër të madh të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, formimi i ekipit EPRMB ka qenë i domosdoshëm ngase fëmijët e këtyre komuniteteve kanë një prevalencë më të lartë të braktisjes dhe mosvijueshmërisë së rregullt të mësimin. Ndonëse ky ekip në nivel komunal në bashkëpunim me ekipet e formuara në nivel shkolle janë funksionale, braktisja e shkollës në këtë komunë vazhdon të jetë mjaft shqetësuese.

Nuk janë hartuar planet e veprimit për parandalimin e braktisjeve, si pjesë e planeve zhvillimore të shkollave apo komunave. Të vetmit akterë që punojnë në parandalim të braktisjes janë mediatorët e angazhuar nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare. Ka disa vite që ka filluar së zbatuari programi i ndërmjetësimit, i cili ka për qëllim ofrimin e mbështetjes për rritjen e qasjes në arsim për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke inkurajuar kështu regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë, përmirësimin e vijueshmërisë si dhe parandalimin e braktisjes së shkollës. Aktivitetet e mbështetjes me programin e ndërmjetësimit kryesisht janë realizuar përmes dy modaliteteve: (i) përmes aktiviteteve në Qendrat Mësimore, dhe (ii) përmes aktiviteteve të ndërmjetësimit arsimor në shkollë, familje dhe komunitet. Ndërmjetësimi arsimor në Kosovë si program mbështetet në përvojat e vendeve evropiane, ndërsa si përvojë u soll dhe vazhdon të zhvillohet përmes projekteve të mbështetura nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Deri më tani MASHT nuk ka hartuar legjislacion ligjor specifik për të mbështetur realizimin e programit të ndërmjetësimit arsimor në Kosovë.¹⁴

Përveç problemeve të lartcekura, problemet e tjera që ndikojnë në braktisje janë të lidhura me përcjelljen e braktisjes nga institucionet arsimore përkatëse. Të dhënat që mblidhen nga drejtoritë komunale të arsimit nuk përputhen gjithmonë me atë se çka kanë raportuar drejtorët e shkollave, gjë e cila dëshmon për metoda të mangëta të mbledhjes së të dhënave dhe mungesë së shkëmbimit të të dhënave ndërmjet institucioneve. Çështja e braktisjes së shkollës nuk kuptohet ashtu siç duhet nga të gjithë zyrtarët komunalë dhe të shkollave që janë përgjegjës për adresimin e saj. Në përgjithësi braktisjet llogariten në bazë të ndryshimit në mes të numrit të nxënësve të regjistruar në fillim të vitit shkollor dhe numrit të nxënësve që mbesin në fund të vitit shkollor. Kjo metodë nuk merr parasysh arsyet e tjera që shtyjnë nxënësit ta braktisin shkollën, sic janë transferimet në shkollat e tjera, vdekjet ose largimi nga Kosova, dhe si pasojë minon llogaritjen e saktë të braktisjeve të shkollës.

13 Intervistë me Islam Shabanin, drejtor i DKA në Fushë Kosovë, 16.10.2017.

14 Instituti Pedagogjik i Kosovës, Raport Studimi: Roli i ndërmjetësuesve në integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor, Prishtinë, 2014.

2.4. Qendrat Mësimore

Në linjë me iniciativat e politikave të institucioneve të Kosovës në fushën e arsimit të komuniteteve jo-shumicë, organizatat jo-qeveritare me mbështetje nga donatorët ndërkombëtarë kanë themeluar qendra mësimore si vende që ofrojnë shërbime plotësuese arsimore për fëmijët në nevojë, me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre në shkollë dhe integrimin të tyre në shoqërinë e gjerë. Krijimi i këtyre qendrave është bazuar në nevojat e komuniteteve, siç janë niveli i pakënaqshëm i performancës së fëmijëve në shkollë, vijimi i parregullt në shkollë, braktisjet e shkollës dhe mungesa e përfshirjes sociale. Roli i qendrës mësimore është të ofrojë programe të mbështetjes mësimore shtesë dhe aktivitete të tjera edukative për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në lokalitetin ku ushtron veprimtarinë. Qendrat mësimore ndër tjera mbështesin rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin parauniversitar, përmirësimin e vijueshmërisë në shkollë dhe rezultateve të të nxënësve, zvogëlimin e braktisjes së shkollimit, vetëdijësimin e komunitetit për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve, përfshirjen aktive të prindërve në edukimin e fëmijëve dhe shtimin e mundësive për socializim të fëmijëve.

Programet e qendrave mësimore krijojnë mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese, të menduarit kritik, të dëgjuarit aktiv, empatisë dhe ndjeshmërisë kulturore duke u bazuar në nevojat fizike dhe emocionale të fëmijëve, përmes metodave të të mësuarit aktiv. Në përgjithësi programet e qendrës mësimore ndihmojnë fëmijët në zhvillimin e të kuptuarit të logjikës dhe matematikës, të shkruarit dhe të folurit, mjedisit fizik dhe atij social e kulturor.

Në të gjithë Kosovën janë krijuar dhe janë funksionale rreth 40 qendra në 15 komuna të Kosovës, kryesisht në komunat ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Duke pasur parasysh se qendrat mësimore janë të menaxhuara nga OJQ të ndryshme, financohen nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe janë të destinuara për komunitete të ndryshme, ato janë të strukturuar ndryshe dhe operojnë ndryshe nga njëra-tjetra. Në përgjithësi, aktivitetet kryesore, që realizojnë QM-të janë ndihma për fëmijët, përgatitja për regjistrim në shkollë, ndihma për kryerjen e detyrave të shtëpisë, sigurimin e vijimit të rregullt të nxënësve në arsimin e detyrueshëm, puna me nxënës që kanë braktisur shkollën, aktivitete rekreative si dhe aktivitete të tjera lidhur me arsimimin e këtyre komuniteteve. Gjatë periudhës 2011-2015, nëpërmjet aktiviteteve të realizuara në qendrat mësimore, të menaxhuara nga organizatat jo-qeveritare, janë prekur jetërat e rreth 8310 fëmijëve, ku kostoja mesatare vjetore për fëmijë ka qenë 123.10 €. ¹⁵

Qendra mësimore e organizatës The Ideas Partnership në Fushë Kosovë ofron mësim plotësues për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, duke përcjellur planprogramin me të cilin punohet në SHFMU “Selman Riza” në Fushë Kosovë ku shumica e përfituesve të kësaj qendre vijnë në mësimin. Mësimi plotësues ofrohet nga vullnetarët dhe planprogrami përgatitet nga pedagogia e qendrës mësimore, e cila po ashtu e monitoron zbatimin e planprogramit, i cili synon të pasqyrojë edhe rezultatet e pritura të të nxënësve. Përveç lëndëve bazike si gjuha shqipe, matematika dhe gjuha angleze, në këtë planprogram përfshihen edhe tema të fushës e shëndetit, jetës dhe punës, si dhe aktivitetet rekreative. Pra, përveç ngritjes së kapaciteteve të nxënësve në aspektin akademik, kjo qendër mësimore synon të zhvillojë edhe shkathësi të tjera tek përfituesit si kulturën e komunikimit, shprehitë e punës, socializimin, dhe vetëdijësimin rreth rëndësisë së shkollimit¹⁶. Sipas pedagoges “më tepër se harmonizimi i planprogrameve mes qendrave të ndryshme mësimore në vend, është i nevojshëm harmonizimi i planeve dhe bashkëpunimi më i ngushtë mes shkollës ku fëmijët vijnë në mësimin dhe qendrave mësimore ku ata vijnë në mësimin plotësues.”¹⁷

15 UBO Consulting, Studim mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë e qendrave mësimore, 2015.

16 Intervistë me Valentina Osmani, pedagoge dhe koordinatorë për mësimdhënie në Qendrën mësimore të Ideas Prtnership në Fushë Kosovë, 18.10.2017.

17 Intervistë me Hysni Hasanin, koordinator i projekteve të Qendrës Ideas Partnership, 18.10.2017.

Ky koordinim mes shkollës dhe qendrave mësimore do t'i mundësonte qendrave mësimore që të ofrojnë edhe më tepër mbështetje akademike për fëmijët gjatë mëimit plotësues.

Shumica e akterëve konfirmojnë se qendrat mësimore kontribuojnë në përmirësimin e performancës në shkollë. Puna e tyre ka rezultuar në vijim më të rregullt në shkollë, nota më të mira, shkallë më të ulët të braktisjes dhe në rritjen e përfshirjes sociale të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në veçanti. Ndër aktivitetet kryesore të QM-ve, me ndikimin më të madh është ndihma që ju është ofruar fëmijëve me detyrat e shtëpisë, të cilat drejtpërsëdrejti kanë ndikuar në performancën e tyre në shkollë.

QM-të operojnë kryesisht nëpërmjet mbështetjes financiare nga donatorët, dhe kjo mbështetje nuk mund të ofrohet në baza afatgjata. MASHT nuk ka zhvilluar një strategji konkrete për qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe ato mbështeten në vullnetarizëm të organizatave të shoqërisë civile. Përkundër që në Strategji parashihet mbështetja e punës së Qendrave Mësimore, MASHT nuk ka ndarë mjete financiare për ofrimin e mbështetjes për këto qendra.

Në vitet e fundit, janë nënshkruar një numër i madh i marrëveshjeve të mirëkuptimit me autoritetet qendrore dhe lokale, nëpërmjet të cilave autoritetet janë zotuar për të siguruar hapësira shkollore për QM-të, që të kryejnë aktivitetet e tyre. Në terma financiare, MASHT dhe autoritetet lokale kanë dështuar në ndarjen e buxhetit që do të mbante QM-të funksionale. Disa nga qendrat mësimore janë mbështetur nga autoritetet komunale me ofrimin në shfrytëzim të hapësirave shkollore pa pagesë, dhe janë liruar nga shpenzimet komunale. Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Graçanicës kanë ofruar po ashtu dhe mbështetje me furnizim me qymyr për sigurimin e ngrohjes në hapësirat e qendrave mësimore gjatë muajve të dimrit.

Një hap pozitiv drejt njohjes së punës së këtyre qendrave dhe përfshirjes së veprimtarisë së tyre brenda kuadrit institucional është aprovimi i Udhëzimit Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore¹⁸, nga ana e MASHT-it në gusht të vitit 2017. Ky Udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të qendrave mësimore, të cilat ofrojnë mbështetje mësimore shtesë dhe aktivitete të tjera edukative për nxënësit e moshës parafillore dhe fillore në Kosovë, në veçanti për nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Udhëzimi parashihet licencimin e qendrave mësimore sipas kushteve të përcaktuara, dhe obligon të gjitha qendrat mësimore t'i harmonizojnë veprimtaritë dhe rregulloret e tyre brenda një periudhe kohore jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ. Po ashtu, të gjitha qendrat mësimore që kanë funksionuar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ dhe të cilat nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë udhëzim lidhur me personelin e qendrës mësimore, kanë një afat prej pesë (5) vitesh për të përmbushur kërkesat për kualifikim në përputhje me këtë udhëzim administrativ.

18 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/ua-masht-nr-12-2017-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qmpdf.pdf>

2.5. Arsimi i lartë për komunitetet

Numri i studentëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që regjistrohen në arsimin universitar përkatësisht në fakultet, është shumë i ulët, pavarësisht se universitetet publike në Kosovë kanë kuota të caktuara për regjistrimin e këtyre studentëve në universitet. Ky nivel i ulët i përfshirjes në arsimin e lartë gjithashtu lidhet kryesisht me gjendjen e rëndë ekonomike të familjeve të këtyre komuniteteve, sepse kostoja e studimeve është shumë e lartë duke përfshirë pagesat semestrale, udhëtimin ose banimin, ushqimin, materialet për studime, etj. Gjithashtu, demotivimit të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve për të kryer studime universitare i kontribuon edhe fakti se shumë kuadro nga këto komunitete me studime të përfunduara nuk arrijnë të gjejnë punë dhe këto raste pastaj shërbejnë si modele demotivuese për të rinjtë e tjerë të këtyre komuniteteve.

Përkundër që mungojnë të dhëna të sakta për pjesëarrjen në arsim të lartë vërehet një rritje e vazhdueshme e numrit të studentëve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas informatave nga Divizioni për Komunitete në MASHT, për vitin akademik 2016/2017 në institucionet publike të arsimit të lartë, për studime bachelor kanë konkuruar 11 kandidatë nga komuniteti rom ndërsa janë pranuar 5, nga komuniteti ashkali kanë konkuruar 49 dhe janë pranuar 25 si dhe nga komuniteti egjiptian kanë konkuruar 25, prej të cilëve janë pranuar 12. Ndërkaq, për numrin e studentëve të cilët ndjekin studimet master dhe doktoraturë, MASHT ka ofruar vetëm numra të përgjithshëm duke iu referuar të gjitha komuniteteve.¹⁹ Përfaqësues të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, por edhe përfaqësues nga menaxhmenti i universiteteve publike në Kosovë, kanë raportuar vazhdimisht për keqpërdorime të shumta që bëhen me kuota për regjistrim të studentëve nga komunitetet joshumicë në universitete publike në Kosovë.

Ndër vështirësitë kryesore me të cilat përballen të rinjtë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për pranim në institucionet e arsimit të lartë është gjendja e tyre e vështirë ekonomike që ndikon në vazhdimin e studimeve tek këto komunitete, por edhe dështimi i tyre për të arritur pragun minimal të pikëve për pranim në universitet. Programi i mbështetur nga Roma Education Fund në Kosovë i quajtur "Roma Versitas" vazhdon të mbështesë me bursa studentët nga këto tri komunitete në studimet universitare. Gjatë vitit 2017, në kuadër të këtij programi kanë përfituar 80 studentë, ndërsa 54 studentë tjerë kanë mbetur në listë të pritjes në mungesë të fondeve. Gjatë vitit akademik 2016/17, MASHT ka ofruar vetëm shtatë bursa për studentët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në shumën prej 500 euro për studentë.

Me qëllim të rritjes së regjistrimit dhe mbajtjes së studentëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim të lartë, Strategjia parashihet zhvillimin e masave të veçanta pozitive dhe të programeve të ndryshme përgatitore. Përkundër kësaj, Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2017, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për sigurimin e kurseve intensive për kandidatët nga komunitetet për t'i përgatitur ata për provimin pranues apo programe të mentorimit për t'i mbështetur studentët e këtyre komuniteteve gjatë studimeve.

19 Për studime të doktoraturës janë paraqitur janë 11 studentë, ndërsa të pranuar janë 2. Në studime master të paraqitur janë 61 dhe të pranuar janë 36.

Në vitin 2016, MASHT ka aprovuar Udhëzimin Administrativ Nr.09/2016 për Aplikimin e Masave Afrimative dhe Kuotave për Regjistrim të Studentëve nga Komunitetet Joshumicë në universitete publike.²⁰ Ky udhëzim parasheh aplikimin e masave afirmative për regjistrimin e komuniteteve në universitetet publike dhe përcakton kuotën 12% të vendeve të rezervuara në të gjitha universitetet publike në Kosovë duke prezantuar formën e vetë-identifikimit etnik për aplikantët. Ndryshe nga mënyrat e mëparshme të aplikuara për identifikim përmes verifikimit nga ana e zyrave komunale për komunitete dhe kthim, partive politike apo organizatave të shoqërisë civile, mekanizmi i ri i prezantuar me këtë udhëzim administrativ është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që parasheh deklarimin e identitetit etnik në bazë të vet-identifikimit. Udhëzimi administrativ gjithashtu parasheh kuota për vende në konviktet studentore për komunitete, megjithëkëtë konkursi i shpallur në afatin e parë nuk e ka përfshirë këtë kriter.

PAPUNËSIA DHE TREGU I PUNËS



20 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/ua-masht-09-2016-aplikimi-i-masave-afirmative-dhe-vendeve-te-rez-al.pdf>

3. Punësimi dhe Mirëqenia Sociale

Varfëria tek anëtarët nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është një fenomen i dallueshëm dhe tipar karakterizues i nivelit të jetesës së këtyre komuniteteve. Niveli i varfërisë së këtyre komuniteteve qoftë kur krahasohet në nivel kombëtarë, apo individual, në të ardhura për kokë banori, me komunitetet e tjera në Kosovë, është mjaft i lartë dhe ka tendencë të vazhdueshme të varfërimit të mëtejshëm. Duke qenë të karakterizuar gjithmonë nga niveli i ulët i edukimit, shkalla e ulët e aftësive dhe formimi arsimor dhe profesional si dhe mundësitë për t'u integruar në tregun e punës, individët e këtyre tri komuniteteve nuk kanë mundur të përfitojnë nga ndryshimet edhe kur këto kanë qenë pozitive për pjesë të tjera të shoqërisë. Gjendja e vështirë në tregun e punës konsiderohet të jetë një nga shkaqet kryesore që ka shtyrë një pjesë të konsiderueshme të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve të emigrojnë gjatë valës së fundit të emigrimeve që mori hov në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015.

Niveli i të ardhurave të familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian rezultojnë të jetë shumë i ulët dhe i pamjaftueshëm për shumicën e familjeve të tyre që të zhvillojnë një jetë në kushte normale. Të dhënat e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (MICS, 2013-2014) për fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nën moshën 18-vjeçare tregojnë se ata janë po ashtu të privuar nga të drejtat dhe nevojat bazike, si ushqyeshmëria, shëndetësia, arsimimi, dhe kushtet adekuate të banimit.²¹

Qendra për Arsim e Kosovës në nëntor të vitit 2016, ka realizuar një hulumtim për gjendjen e përgjithshme dhe problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë duke anketuar 150 anëtarë nga familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në tri komuna: Komuna e Gjakovës, Komuna e Pejës dhe Komuna e Istogut.²² Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, duket se trendi i të jetuarit në familje të mëdha shumë-anëtarëshe është një mënyrë e tejkualuar në mesin e këtyre tri komuniteteve, meqenëse vërehet se pjesëtarët e tyre jetojnë kryesisht në familje të vogla të përbëra nga familja bërthamë, me një mesatare prej rreth 6 anëtarësh. Ndërsa, familjet shumë-anëtarëshe janë të rralla. Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi 63.3% janë familje me 1 deri 6 anëtarë, 26% janë familje me 7 deri 8 anëtarë, ndërsa vetëm 10.7% janë familje me 9 deri 13 anëtarë.

Po ashtu, të gjeturat e këtij hulumtimi, konstatojnë se të ardhurat e familjes janë të mjaftueshme vetëm sa për të mbijetuar. Niveli i të ardhurave mujore (prej të gjitha burimeve: pagat, pensionet, ndihmat sociale, remitancat, nga puna vetanake, nga bujqësia, ndihma nga individë apo organizata të ndryshme) të familjeve të këtyre komuniteteve del të jetë jashtëzakonisht e ulët, që ju pamundëson shumicës së familjeve të tyre të jetojnë në kushte normale. Më shumë se gjysma e familjeve (53.7%), kanë të ardhura mujore prej 0 deri 200 euro në muaj, ndërsa 27.3% e familjeve kanë të ardhura mujore prej 200 deri në 350 euro. Mesatarja e përgjithshme e të ardhurave mujore të një familje në mesin e këtyre tri komuniteteve është 252.84 euro në muaj. Nëse pjesëtojmë këtë mesatare me mesataren e numrit të anëtarëve të familjes (6 anëtarë), atëherë rezultojnë se 1 person jeton me 42.14 euro në muaj, gjegjësisht me 1.4 euro në ditë.

21 Agjencia e Statistikave të Kosovës. (Tetor, 2014). Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës: Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.

22 Qendra për Arsim e Kosovës, Raport i Hulumtimit "Gjendja e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë", Gjakovë, Pejë, Istog, Prishtinë, Nëntor 2016.

3.1. Papunësia dhe tregu i punës

Papunësia në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë më e madhe se te komunitetet e tjera etnike në Kosovë, gjë që ndërlidhet me shumë aspekte sociale dhe pasoja të mëdha në zhvillimin e këtyre komuniteteve. Vetëm një numër i vogël i tyre janë të punësuar në sektorin publik dhe në sektorin privat, ndërsa pjesa më e madhe janë të papunësuar që kryesisht kërkojnë punë, ose janë të vetë-punësuar që punojnë punë nga më të ndryshmet. Vendet e punës në të cilat janë të angazhuar janë shpesh të përkohshme, kryesisht punë fizike që nuk kërkojnë shkathhtësi të larta dhe nuk paguhen mirë²³. Po ashtu, një përqindje e madhe e tyre, në veçanti femrat janë amvise, ndërsa një numër i tyre, kryesisht meshkujt merren me bujqësi. Sipas të dhënave nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në vitin 2011, papunësia e komuniteteve rom dhe ashkali kishte arritur shkallën prej 60%, ndërsa për komunitetin egjiptian 80%, që tregon për një papunësi shumë të lartë nga radhët e këtyre komuniteteve krahasuar me grupet e tjera etnike, shkalla e papunësisë e të cilëve sillet nga 38-50%.²⁴

Disa nga shkaqet kryesore për gjendjen e punësimit janë specifike për këto komunitete ose i prekin këto komunitete më shumë se të tjerët e ato janë: niveli mesatarisht më i ulët i shkollimit/shkathhtësive tek këto komunitete, diskriminimi në treg të punës dhe qasja më e ulët në lidhje/rrjete joformale që do t'u mundësonte punësimin²⁵. Situata në tregun e punës është edhe më e rëndë për gratë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ku vetëm 9% e të cilave janë të punësuar²⁶. Shkaqet për dallimet gjinore janë të ndërlidhura dhe përfshijnë martesat e hershme, nivelin më të ulët të shkollimit (në krahasim me meshkujt), dhe stereotipet gjinore ku gruaja konsiderohet si përgjegjëse për kujdesin ndaj shtëpisë dhe familjes²⁷.

Në përgjithësi, qasja në shërbime të punësimit dhe trajnime profesionale të ofruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe organizata të tjera, është e kufizuar nga niveli i informimit të punëkërkuësve dhe kapaciteti i MPMS për t'i ofruar shërbime një numri aq të madh të punëkërkuësve. Në rastin e komuniteteve rom, ashkali e egjiptian, niveli i informimit të punëkërkuësve është i ulët dhe ata përballen me pengesa të shumta për pjesëmarrje në masat aktive të tregut të punës (MATP), që ndërlidhen me kriteret e disa skemave, siç janë niveli i shkollimit/njohurive paraprake, e tjera, që në të shumtën e rasteve janë kriteret përjashtuese për këto komunitete.

Niveli dhe cilësia e hulumtimeve mbi gjendjen e tregut të punës, nuk përfshijnë të dhëna lidhur me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Si pasojë krahasimi i performancës në tregun e punës së këtyre komuniteteve në raport me mesataren e vendit është i vështirë. MPMS në statistikat e rregullta nuk raporton në nivel të komuniteteve specifike dhe nuk publikon raporte mbi përfitimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nga shërbimet dhe masat e ofruara nga MPMS. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë informata të mjaftueshme për zyrat e punësimit, për qendat e aftësimi profesional, dhe për kategoritë e përfitimit nga skemat sociale. Mungesa e fushatave të informimit për këto shërbime zvogëlon mundësitë e këtyre komuniteteve për t'iu qasur tregut të punës. Përkundër aktiviteteve të paraparë në Strategji,

23 Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Gjendja e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2010, dhe Organizata Botërore e Punës, Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i OBP 2007/4.

24 UNDP Remittances Survey 2011, në UNDP: Kosova Human Development Report 2012. Private Sector and Employment. (UNDP, 2012).

25 Organizata Botërore e Punës, Tranzicioni i të Rinjve në Punë të Mirë: Dëshmitë nga Kosova, Dokumenti i Politikave të Punësimit i OBP 2007/4. Megjithëse situata sa i përket nivelit të shkollimit po ndryshon, dallimet me komunitetet tjera ekzistojnë, dhe atë sidomos në pjesën e popullatës që tanimë janë moshë të punës.

26 Fondacioni CREATE dhe Qendra për Dokumentim Romë dhe Ashkali (RADC). Gratë Rome, Ashkali dhe Egjiptase në Qeverisje dhe Ekonomi.

27 Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës, Pozita e Grave të Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, 2008.

gjatë vitit 2017, MPMS nuk ka organizuar asnjë fushatë informimi për shërbimet e punësimit dhe MATP-ve përfshirë trajnimet profesionale. Po ashtu, MPMS ka dështuar në punësimin e këshilltarëve të punësimit nga radhët e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian.

Numri i punëkërkuessve të regjistruar në shërbimet publike të punësimit nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian deri në vitin 2017 është 5,552 (Tabela 10) apo 5.2% e numrit të përgjithshëm të punëkërkuessve të regjistruar (106,673).

Tabela 10. Punëkërkuessit e regjistruar sipas etnicitetit

Etniciteti	Grupmosha		
	Gj	F	M
Shqiptar	90,432	41,010	49,422
Serb	6,790	3,060	3,730
Tjetër	3,899	1,948	1,951
Rom	1,940	826	1,114
Ashkali	2,860	1,033	1,822
Egjiptian	752	336	416
Gjithsej	106,673	48,218	58,455

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, dhjetor 2017

Në mesin e punëkërkuessve të regjistruar nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 60.4% janë meshkuj, ndërsa 39,6% janë femra. Në mesin e punëkërkuessve të regjistruar dominojnë të rinjtë e grup moshës 15-24 vjeçare (me rreth XX%), ndërsa grupmoshat 25-39 vjeçare dhe 40-54 vjeçare përbëjnë rreth XX% dhe XX%, përkatësisht (Tabela 11).

Tabela 11. Punëkërkuessit e regjistruar sipas grupmoshës në vitin 2017

Grupmosha	Rom			Ashkali			Egjiptian			Tri komunitetet		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
15-24	85	46	39	138	56	82	71	39	32	294	141	153
25-39	61	24	37	76	29	47	62	32	30	199	85	114
40-54	38	19	19	42	24	18	30	16	14	110	59	51
55+	14	9	5	9	4	5	6	3	3	29	16	13
Gjithsejt	198	98	100	265	113	152	169	90	79	632	301	331

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, Dhjetor 2017

Numri më i madh i punëkërkuessve të regjistruar nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë të pakualifikuar ose me shkollë fillore (XX%), ndërsa XX% kanë përfunduar shkollën e mesme (Tabela 12).

Tabela 12. Punëkërkuessit e regjistruar sipas kualifikimit në vitin 2017

Niveli i arsimimit	Rom			Ashkali			Egjiptian			Tri komunitetet		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
I pa shkolluar	127	56	71	168	78	90	75	39	36	370	173	197
Klasat I-IX (shkolla fillore)	47	29	18	68	24	44	69	37	32	184	90	94
Arsimi i mesëm profesional	22	12	10	27	11	16	21	13	8	70	36	34
Arsimi i mesëm gjimnaze	1	0	1	1	0	1	3	1	2	5	1	4
Bachelor	1	1	0	1	0	1	1	0	1	3	1	2
Master	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PhD	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsejt	198	98	100	265	113	152	169	90	79	632	301	331

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, Dhjetor 2017

MPMS, për punëkërkuessit e regjistruar në Zyrat e Punësimit, ofron shërbime këshillimi, ndërmjetësim në punë, trajnime profesionale dhe pjesëmarrje në skema të ndryshme të masave aktive të tregut të punës (p.sh. subvencionim page, praktikë në punë, projekte për punësim sezonal, grante për fillim biznesi, e të tjera). Sigurimi i pjesëmarrjes në MATP për komunitetet jo shumicë zakonisht sigurohet përmes kuotës për këto komunitete, në kuadër të skemave të MATP. Dizajnimi dhe monitorimi i shërbimeve dhe MATP-ve nuk bëhet me pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. communities.

Masat aktive në tregun e punës kanë për qëllim zbutjen e papunësisë. “Aftësimi Profesional” është ndër masat më të rëndësishme, që ofrohet nga tetë Qendrat të Aftësimi Profesional (QAP), që operojnë nën administrimin e Agjencisë për Punësim të Republikës së Kosovës (APRK). Qendrat për Aftësim Profesional ofrojnë trajnime falas për punëkërkuessit për një profesion të caktuar duke u përqendruar në aplikimin e shkathhtësive dhe njohurive praktike duke përdorur mësimin në klasë si dhe në kabinete të ndryshme. Qëllimi i këtyre trajnimeve është që të mundësojnë një ngritje ose adaptim të njohurive profesionale, shkathhtësive dhe qëndrimeve të nevojshme për performancë efikase brenda një profesioni, me qëllim të rritjes së perspektivës së pjesëmarrësve në punësim ose ruajtjen e punësimit të tyre.

Masa “Punë publike” ofron punësim afatshkurtër duke përmirësuar infrastrukturën lokale. Qëllimi i programeve për punët publike është gjenerimi i punësimit të përkohshëm për të papunësuarit e regjistruar përmes zbatimit të projekteve intensive që absorbojnë fuqi punëtore si dhe mirëmbajtja dhe rehabilitimi i pasurive (aseteve) komunale dhe të hapësirave publike.

Masa e “Subvencionit për Punësim” synon të krijojë mundësi punësimi për punëkërkuessit duke subvencionuar punëdhënësit që t’i rekrutojnë ata në baza afatgjata. Pjesëmarrësit në këtë skemë synohet të mbesin në vend pune pas përfundimit të periudhës së subvencionimit. Këto janë transferat e drejtpërdrejta për punëdhënësit për t’i inkurajuar ata që të punësojnë grupet e caktuara me vështirësi për të gjetur punë. Po ashtu, subvencionet për punësim mund të ndihmojnë punëdhënësit për të zgjeruar biznesin e tyre dhe për të punësuar staf të ri, duke krijuar kështu më shumë vende të punës.

Masa e “Vetë-Punësimit” ka për qëllim kryesor që të ofrojë mundësi për të papunësuarit e regjistruar për të filluar një aktivitet biznesi. Kjo masë ndihmon të papunësuarin për nisjen e një biznesi, ose ofrimin e trajnimit dhe këshillimit të vetëpunësuarve për të zhvilluar dhe menaxhuar një biznes. Qëllimi kryesor i kësaj mase është adresimi i papunësisë përmes vetëpunësimit si dhe krijimi i vendeve të reja të punës në kompanitë e vogla.

Masa e “Praktikës në Punë” synon të ofrojë mundësinë e fitimit të përvojës së vlefshme në mjedisin e punës për pjesëmarrësit që kërkojnë të hyjnë në fushën e caktuar të karrierës. Qëllimi kryesor i kësaj mase është të zhvilloj aftësitë dhe të shtoj perspektivat e të sapo diplomuarëve për punësim. Masa ka për qëllim rritjen e perspektivës të punësimit për të papunët që kërkojnë punë për herë të parë.

Masa e “Trajnimit në Punë”, përfshinë trajnimin nga një punëdhënësi që i është ofruar punëkërkuessit gjatë angazhimit në punën produktive e cila zhvillon njohuri ose aftësi thelbësore për kryerjen e një pune specifike me një performancë adekuate. Qëllimi kryesor i kësaj mase është të ngritë aftësitë dhe perspektivat e punëkërkuessit për punësim.

Në vitin 2017, numri i përfituesve në MATP nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ishte 112 (24 femra) dhe këta përbënin 4% të numrit të përgjithshëm të përfituesve nga MATP (2,800 përfitues) (Tabela 13). Disa MATP për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ofrohen edhe në kuadër të aktiviteteve për riatdhesim. Që nga viti 2012, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në bashkëpunim me MPMS dhe UNDP, kanë zhvilluar aktivitete për mbështetjen e trajnimit dhe punësimit të personave të riatdhesuar në kuadër të Programit Aktiv të Tregut të Punës për Rininë në Kosovë. Në kuadër të programit të ri-integrimit, ofrohet financim i planeve të biznesit për personat e riatdhesuar të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren QRK Nr. 04/2016 për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të ri-integrimit.

Tabela 13. Përfituesit e PATP, sipas përkatësisë etnike dhe sipas llojit në vitin 2017

Përkatësia etnike	Politikat Aktive të Tregut të Punës (PATP)														
	Skema e praktikës			Punë Publike			Subvencionim i pagave			Trajnimi në vendin e punës			Vetëpunësim		
	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M	Gj	F	M
Rom	2	0	2	2	0	2	8	0	8	9	4	5	6	0	6
Ashkali	4	1	3	21	0	21	20	2	18	22	11	11	3	0	3
Egjiptian	5	3	2	3	0	3	2	1	1	5	2	3	0	0	0
Shqiptar	656	408	248	785	41	744	630	254	376	386	198	188	21	2	19
Serb	24	6	18	50	6	44	34	12	22	47	20	27	0	0	0
Tjerë	19	10	9	12	0	12	16	7	9	3	1	2	5	0	5
Gjithsej	710	428	282	873	47	826	710	276	434	472	236	236	35	2	33

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, Dhjetor 2017

Në vitin 2017, nga gjithsej 710 përfitues, 11 kandidatë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë përfshirë në skemën praktikant. Në vitin 2017, 36 kandidatë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë ndjekur trajnimin në vendin e punës në kompani nga gjithsej 472 përfitues. Po ashtu, në të njëjtin vit, nga 873 përfitues, 26 kandidatë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë përfshirë në punësim të përkohshëm përmes skemës së punëve publike. Në skemën e subvencionimit të pagës, kanë përfituruar 30 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga gjithsej 710 përfitues, ndërsa nga skema e vetëpunësimit kanë përfituruar 9 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, nga gjithsej 35 përfitues.

Sipas të dhënave të MPMS, në vitin 2017 janë realizuar 67 (prej të cilave, 19 femra) ndërmjetësime të rregullta në punësim për pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga Zyrat për Punësim, që përbën 3% të numrit të përgjithshëm të ndërmjetësive të rregullta në punësim nga MATP (2,198 përfitues) (Tabela 14).

Tabela 14. Ndërmjetësimet në punësim të rregullta në vitin 2017

Etniciteti	Gj	F	M
Shqiptar	2012	740	1272
Serb	57	26	31
Tjetër	62	33	29
Rom	18	11	7
Ashkali	27	5	22
Egjiptian	22	3	19
Gjithsej	2198	818	1380

Burimi: Sistemi Informativ për Menaxhimin e Punësimit, APRK, Tetor 2017

Trendi i përfshirjes në programet e aftësimin profesional ka shënuar rënie në vitin 2017, krahasuar me vitin paraprak. Përderisa, në vitin 2016, 301 kandidatë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë trajnuar në Qendrat e Aftësimin Profesional, në vitin 2017, janë trajnuar vetëm 169 kandidatë (Tabela 15), që paraqet një rënie prej 44%.

Tabela 15. Pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në trajnime

Qendra e Aftësimit Profesional (QAP)

	Rom	Ashkali	Egjiptian	Gjithsej
Ferizaj	9	5	3	17
Prizren	22	7	1	30
Gjilan	3	-	-	3
Mitrovicë	-	4	2	6
Pejë	8	8	27	43
Prishtinë	11	7	3	21
Gjakovë	13	3	33	49
Gjithsej	66	34	69	169

Burimi: MPMS, Periudha Janar – Shtator 2017

3.2. Ndiham sociale dhe pensionet

Pjesa më e madhe e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jetojnë në varfëri ekstreme²⁸ dhe vazhdojnë të përballen me kushte të vështira të jetesës²⁹. Situata është posaçërisht e vështirë për 20% të më të varfërve të këtyre komuniteteve dhe familjeve që jetojnë në zonat rurale³⁰. Studimi i UNDP-së i vitit 2013³¹ në komunën e Fushë Kosovës dhe Obiliqit ka gjetur se dy të tretat e familjeve të komunitetit rom, afër gjysma e komunitetit ashkali dhe mbi një e treta e komunitetit egjiptian hasin vështirësi në plotësimin e nevojave për ushqim dhe nevojave të tjera elementare.

28 World Bank, Kosovo Country Snapshot, 2015.
 29 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014; Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2015; Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Raporti i Zhvillimit Njerëzor, 2010.
 30 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014.
 31 Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Community Vulnerability Assessment Report, 2013.

Për të zbutur nivelin e varfërisë në Kosovë ekzistojnë vetëm dy skema të ndihmës sociale. Ndiham sociale të kategorisë së parë e realizon familja³² në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur dhe të paaftë për punë të paguar³³ dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar (vlera bazë sillet nga 50 EUR për familjet me një anëtar deri në 150 EUR me 15 anëtarë)³⁴. Ndiham sociale të kategorisë së dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë (i cili duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në Zyrrën e Punësimit) dhe me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç apo që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç (vlera bazë sillet nga 50 EUR për familjet me një anëtar deri në 150 EUR me 15 anëtarë). Familjet përfituese të ndihmës sociale për çdo fëmijë të moshës deri 18 vjeç, realizojnë një përfitim financiar prej 5 euro në formën e shtesës për fëmijë, me qëllim të nxitjes së arsimimit dhe përmirësimit të shëndetit, si dhe kanë të drejtë të aplikojnë për lirim nga pagesa për rreth 20 Euro nga shpenzimet mujore të energjisë elektrike. Po ashtu, lirohen nga taksat komunale, nga shpenzimet për ujë dhe ngrohjen, dhe ju mbulohen shpenzimet për regjistrimin e semestrit në universitetet publike.

Kriteret e vlerësimit për të përfituar nga ndihma sociale nuk janë të përshtatshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Këto tri komunitete përjashtohen nga përfitimet për shkak të disa kriterëve që nuk përshtaten me kushtet dhe rrethanat e Kosovës. Vlen të theksohet se nëse një familje punon disa ditë dhe pranon pagesën përmes bankës, humb asistencën sociale. Në këtë drejtim, një ndër problemet evidente të ndihmës sociale është edhe punësimi sezonal nëpër disa komuna ku përfshihen një pjesë e anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në këtë rast një pjesëtar i komunitetit, që njëherit është përfitues i skemës së asistencës sociale, sapo të fillon me punë sezonale i ndërpritet ndihma sociale dhe e ka të vështirë të rikthehet në skemën e përfituesve, duke ndikuar kështu në mos-interesimin për punë sezonale.

Qeveria ka dështuar të organizojë fushata informuese për skemat e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale dhe kriteret për qasje në këto skema. Në mungesë të informacioneve, shumica e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian aplikojnë për kategorinë e dytë të ndihmës sociale në të cilën kriter kyç është që familja të ketë një fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Plotësimi i këtij kushti, rrit shkallën e lindshmërisë, duke thelluar edhe më tej varfërinë.

Mos-regjistrimi civil i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian³⁵ është një pengesë tjetër për qasje në mbrojtje sociale. Sipas Ligjit për Skemat e Ndihamve Sociale, për tu kualifikuar për ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes aplikuese duhet të janë të pajisur me dokumente të Kosovës. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për numrin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve që nuk janë të regjistruar³⁶, vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të këtyre komuniteteve nuk janë të regjistruar. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës, ka ndër marrë hapa pozitiv në stimulimin e regjistrimit duke organizuar fushata informuese dhe vetëdijesuese për përparësitë e regjistrimit civil, pasojat nga mos-regjistrimi, si dhe duke i liruar nga pagesa për regjistrim.

32 Sipas Ligjit për Skemën e Ndihamve Sociale (Neni 2, paragrafi 1) familja përbëhet prej atyre personave nevojat e të cilëve merren parasysh me rastin e vendosjes së përzgjedhshmërisë dhe shumës së ndihmës sociale, dhe përkufizohet si një bashkësi që përbëhet prej paraqitësit të kërkesës ose marrësi të ndihmës dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, të cilët janë në bashkësi familjare.
 33 Person i/e varur - përkufizohet si individ i cili i takon njërit prej grupeve që vijojnë: personat që janë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç (18 vjeç) dhe të cilët kanë të meta të rënda dhe aftësi përherë të kufizuara që e bëjnë atë të paaftë për të punuar për punë shpërblyese, personat që janë gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç apo më të moshuar, kujdestarët e përhershëm të personave me aftësi të kufizuara apo të personave në moshën 65 vjeç ose më të vjetër të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, apo fëmija nën moshën 5 vjeç, personat deri në moshën 14 vjeç, personat ndërmjet moshave 15 dhe 18 vjeç dhe të cilët janë në shkollim të rregullt të mesëm, prindërit vetushqyes me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.
 34 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Mirëqenies Sociale 2015, 2016.
 35 OSBE, 2012, Kontribut për shqyrtimin e progresit të planit të veprimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë 2009-2015.
 36 Bashkimi Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën, 2015.

Në një rën të anë, sipas të dhënave të MPMS-së, 2,526 familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kanë pranuar ndihma sociale gjatë vitit 2017 (Tabela 16), e që përbëjnë 10% të numrit të përgjithshëm të familjeve përfituese në Kosovë. Numri i përgjithshëm i familjeve në skemën e ndihmës sociale është 25,270 familje. Të dhënat në anën tjetër tregojnë se numri i familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që kanë përfituar ndihma sociale ka shënuar rritje prej 28.8% nga viti 2015 (1,961 familje) duke rritur kështu edhe vlerën e përfituar monetare.

109 fëmijë me aftësi të kufizuara të grup moshës 1-18 vjeç nga radhët e komuniteteve rom (33), ashkali (58) dhe egjiptian (18) kanë përfituar 100 euro/muaj gjatë vitit 2017, në kuadër të Skemës për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

Tabela 16. Familjet dhe anëtarët e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në SNS

Nacionaliteti	Nr. Familjeve		Nr. Anëtarëve		Shuma	
		%		%		%
Rom	939	3.99%	4,234	4.03%	90,828.75	3.90%
Ashkali	1,282	5.28%	6,215	5.90%	128,393.75	5.50%
Egjiptian	305	1.30%	1,503	1.42%	30,958.75	1.33%
Gjithsej	2,526	10.57%	11,952	11.35%	250,181.25	10.57%

Burimi: MPMS, Dhjetor 2017

Në përgjithësi, sipas të dhënave të MPMS-së, numri më i madh i familjeve përfituese të ndihmës sociale nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është në Fushë Kosovë (452 përfitues), në Gjakovë (318), Obliliq (240), Ferizaj (235) dhe Pejë (235). Ndërsa, nga 2,526 familje përfituese 1,424 familje përfitojnë në kuadër të kategorisë së dytë të skemës sociale (Tabela 17 dhe 18).

Tabela 17. Numri i familjeve, anëtarëve dhe shuma e mjeteve sipas QPS-ve dhe kategorisë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

QPS	Gjithsej			Kategoria I			Kategoria II		
	Familje	Anëtarë	Shuma	Familje	Anëtarë	Shuma	Familje	Anëtarë	Shuma
Artanë	9	36	811.25	8	30	697.50	1	6	113.75
Deçan	17	77	1,646.25	13	62	1,292.50	4	15	353.75
Ferizaj	235	1182	24,023.75	71	303	6,607.50	164	879	17,416.25
Fushë Kosovë	452	2251	45,850.00	144	593	13,138.75	308	1658	32,711.25
Gjakovë	318	1499	31,652.50	115	390	9,725.00	203	1109	21,927.50
Gjilan	41	157	3,530.00	28	86	2,141.25	13	71	1,388.75
Graçanicë	49	229	5,046.25	21	63	1,895.00	28	166	3,151.25
Istog	53	243	5,166.25	13	47	1,122.50	40	196	4,043.75
Kamenicë	57	221	5,181.25	48	164	4,123.75	9	57	1,057.50
Klinë	22	97	2,147.50	15	54	1,351.25	7	43	796.25
Klllokot	1	5	102.50	0	0	0.00	1	5	102.50
Leposaviç	9	29	707.50	7	16	468.75	2	13	238.75
Lipjan	173	836	17,573.75	54	213	4,891.25	119	623	12,682.50
Malishevë	1	5	102.50	0	0	0.00	1	5	102.50
Mamushë	2	10	205.00	0	0	0.00	2	10	205.00
Mitrovica Veriut	20	66	1,677.50	13	34	993.75	7	32	683.75
Mitrovicë	156	711	15,108.75	85	331	7,561.25	71	380	7,547.50
Obiliç	240	1076	23,052.50	135	498	11,693.75	105	578	11,358.75
Pejë	235	1156	23,627.50	104	406	9,171.25	131	750	14,456.25
Podujevë	70	390	7,331.25	41	241	4,313.75	29	149	3,017.50
Prishtinë Kodra e Diellit	7	26	621.25	5	18	438.75	2	8	182.50
Prishtinë Kodra e Trimave	48	205	4,538.75	28	108	2,420.00	20	97	2,118.75
Prizren	123	551	11,922.50	58	208	5,000.00	65	343	6,922.50
Rahovec	64	282	6,155.00	34	125	2,921.25	30	157	3,233.75
Shtërpçë	4	18	387.50	3	13	285.00	1	5	102.50
Shtime	47	239	4,775.00	23	111	2,248.75	24	128	2,526.25
Suharekë	39	209	4,108.75	19	88	1,833.75	20	121	2,275.00
Viti	2	10	195.00	1	5	92.50	1	5	102.50
Vushtrri	30	129	2,762.50	15	56	1,247.50	15	73	1,515.00
Zveçan	2	7	171.25	1	2	68.75	1	5	102.50
Gjithsej	2526	11952	250,181.25	1102	4265	97,745.00	1424	7687	152,436.25

Burimi: MPMS, Dhjetor 2017

Tabela 18. Numri i familjeve sipas kriterit dhe gjinisë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

	Gjithsej			Kategoria I			Kategoria II		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Rom	729 77.64%	210 22.36%	939	306 61.08%	195 38.92%	501	423 96.58%	15 3.42%	438
Ashkali	1084 84.56%	198 15.44%	1282	309 63.32%	179 36.68%	488	775 97.61%	19 2.39%	794
Egjiptian	262 85.90%	43 14.10%	305	71 62.83%	42 37.17%	113	191 99.48%	1 0.52%	192
Gjithsej	2075	451	2526	686	416	1102	1389	35	1424

Burimi: MPMS, Dhjetor 2017

Tabela 19. Numri i bartësve sipas kategorisë dhe gjinisë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Kriteri	Rom			Ashkali			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Prind vetushqyes	46	52	98	8	35	43	5	18	23	59	105	164
Person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80%	89	52	141	143	40	183	41	9	50	273	101	374
I papunësuar	425	11	436	775	3	778	193	2	195	1393	16	1409
Kujdestar	128	54	182	140	100	240	16	10	26	284	164	448
Person me Pension të Aftësisë së Kufizuar (PPAK)	2	0	2	5	1	6	2	0	2	9	1	10

Kriteri	Rom			Ashkali			Egjiptian			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Person me pension themelor	0	1	1	1	1	2	0	0	0	1	2	3
Person i vetëm - Person mbi 18 vjeç, i paaftë për punë mbi 80%	39	39	78	1	0	1	5	4	9	45	43	88
Gjithsej	729	209	938	9	18	27	262	43	305	2,064	432	1,270

Burimi: MPMS, Dhjetor 2017

Sipas të dhënave të MPMS, në vitin 2017, 457 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian pranojnë pensionet bazë (Tabela 20). Një sqarim i ofruar për këtë numër të vogël është theksuar të jetë jetëgjatësia e shkurtër e këtyre komuniteteve, e cila llogaritet të jetë, mesatarisht, 60 vjeç³⁷. Numri i vogël i përfituesve nga pensioni kontributiv (173 pjesëtarë) mund të lidhet me faktin se punësimi tek këto komunitetet mbetet vazhdimisht i ulët.

Tabela 20. Numri i përfituesve të pensioneve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

	Rom	Ashkali	Egjiptian	Tri komunitetet
Pensioni bazë	168	181	108	457
Pensioni kontributiv	73	69	31	173
Pensioni për personat me aftësi të kufizuar	83	127	12	222

Burimi: MPMS, Dhjetor 2017

³⁷ Sigurimi i ri shëndetësor do të shpëtojë jetë: Jetëgjatësia dhe shëndeti në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, Balkan Sunflowers, 2016.

3.3. Punësimi në sektorin publik

Në kuadër të kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, përfaqësimi proporcional i komuniteteve në punësim në sektorin publik është i mbrojtur në Kushtetutë.³⁸ Për më tepër, Ligji për Shërbimin Civil garanton për parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit, mundësive dhe përfaqësimit të barabartë, dhe në mënyrë specifike thekson që komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil dhe organet e administratës publike qendrore dhe lokale. Në veçanti, neni 11.3 i Ligjit përcakton se në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimum 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilët u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për anëtarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë numri i vendeve të punës do të jetë i rezervuar në pajtim me përfaqësimin procentual të komuniteteve të komunës së dhënë.

Përveç kësaj, Ministria e Administratës Publike (MAP) ka aprovuar Rregulloren për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës (Rregullorja nr. 04/2010), e cila rregullon përfaqësimin e komuniteteve në kategoritë e ndryshme të shërbimit civil, përcakton procedurat për institucionet punëdhënëse për të siguruar përfaqësimin e drejtë dhe proporcional si dhe përfshin masat e rekrutimit të drejtë dhe masat e veçanta të veprimit pozitiv që duhet të zbatohen. Rregullorja nr. 04/2010 përcakton masat e monitorimit dhe raportimit që duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e saj të duhur, si dhe udhëzimet për mbledhjen e të dhënave statistikore anonime mbi përkatësinë e komunitetit të shërbyesve civilë me qëllim që të vlerësojë nëse komuna apo institucioni e ka arritur pragun minimal të përfaqësimit të komuniteteve.

Përkundër faktit që përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil është i rregulluar me anë të Ligjit për Shërbimin Civil dhe Rregulloren nr. 04/2010, ende nuk ka qartësi juridike nëse pragu për përfaqësimin e komuniteteve në pakicë numerike në nivel qendror duhet të zbatohet veç e veç për çdo institucion, apo nëse është një prag i përgjithshëm që duhet të zbatohet përgjithësisht në institucionet si tërësi dhe sesi (ose nëse) duhet të zërthehet përqindja sipas komuniteteve të ndryshme.³⁹ Në nivel komunal ekzistojnë dykuptimësi nëse përfaqësimi i komuniteteve duhet të llogaritet në bazë të një përqindjeje të përgjithshme për të gjitha komunitetet në pakicë numerike, ose nëse përfaqësimi duhet të vlerësohet për çdo komunitet të veçantë që jeton në komunë.⁴⁰

Institucionet në Kosovë kanë dështuar në zbatimin e obligimeve ligjore që garantojnë përfaqësim të drejtë dhe proporcional të komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil në të dy nivelet, atë komunal dhe qendror. Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në shërbimin civil si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal në krahasim me pjesëmarrjen që kanë në totalin e popullsisë në një komunë të caktuar. Sipas Raportit të Ministrisë së Administratës Publike mbi gjendjen në shërbimin civil në vitin 2016, në shërbimin civil (nivele qendror dhe lokal), janë të punësuar 24 romë (0.15%), 20 ashkali (0.13%), dhe 12 egjiptianë (0.07%), prej të cilëve vetëm në shërbimin civil në nivel qendror janë 13 romë, 10 ashkali dhe 5 egjiptianë.⁴¹ Në kuptim të nivelit të

38 Shih nenin 61 të Kushtetutës: “komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë në përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet.” dhe nenin 101.1: “përbërja e shërbimit civil reflekton diversitetin e popullit të Kosovës dhe i merr parasysh parimet e barazisë gjinore të njohura botërisht”.

39 Një raport i botuar nga Instituti Demokratik i Kosovës për KDIK, me titull “Hetimi Parlamentar – Përfaqësimi i Komuniteteve Joshumicë në Shërbimin Civil të Kosovës” jep udhëzime jodetyruese ku citohet komentari i Kushtetutës, i cili në lidhje me nenin 101.1 përcakton se “shpërndarja e dhjetë përqind të pozitave të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë duhet të bëhet në bazë të kuotave proporcionale për të pasqyruar pozitën e secilit komunitet në Kosovë si tërësi, me qëllim të garantimit të pjesëmarrjes shumetnike në shërbimin civil dhe zbatimit praktik në administratën publike të Kosovës”.

40 OSBE, Përfaqësimi i Komuniteteve në Shërbimin Civil të Kosovës, maj 2017.

41 Ministria e Administratës Publike, Raporti për gjendjen në shërbimin civil për vitin 2015, korrik 2016.

pozitës, komunitetet jo-shumicë kryesisht mbajnë pozita profesionale dhe administrative dhe janë në përgjithësi të nënpërfaqësuar në nivelin menaxherial të institucioneve publike. Pothuajse të gjithë nëpunësit civilë romë, ashkali dhe egjiptianë kanë pozita të nivelit të ulët (në nivel administrate) në krahasim me punonjësit nga komunitetet e tjera.

Vështirësitë kryesore në punësimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë niveli i ulët i punësimit në përgjithësi në Kosovë (vende të pakta të punës) dhe mungesa e kualifikimeve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian për shkak të mos ndjekjes së shkollimit.

Qeveria e Kosovës nuk ka zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe raportim të rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese për sigurimin e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucione publike në nivel qendror dhe lokal. Raportohet se ka edhe raste kur pjesëtarët e komunitetit shqiptar vetë-raportohen si pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë për të përfutur nga masat e aksionit afirmativ.

4. Rekomandimet

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, në vitin e parë të zbatimit të saj mbetet larg përmbushjes së synimeve të përcaktuara kryesisht për shkak të mungesës së angazhimit politik, burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për monitorimin e progresit, koordinimit jo të mirë të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë shfrytëzimin e pamjaftueshëm të ekspertizës së organizatave të shoqërisë civile që punojnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZQM), si institucion përgjegjës i ngarkuar për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj. Kjo mungesë e kapaciteteve ka ndikuar negativisht në koordinimin institucional dhe vendosjen e një sistemi të rregullt institucional për monitorim dhe raportim të zbatimit të Strategjisë në nivel qendror dhe lokal.

Në anën tjetër, komunat nuk kanë krijuar mekanizma për monitorim të zbatimit të Strategjisë, siç është planifikuar në Strategji, si dhe nuk kanë ndarë mjete financiare për vitin 2017. Pengesat në zbatimin e Strategjisë në nivel lokal janë të ndikuara nga vonesa të institucioneve përgjegjëse qendrore në finalizimin e termave të referencës për Komitetet Komunale Vepruese (KKV).

Nga analiza mund të nxirren këto rekomandime:

Në përgjithësi vlerësohet se fëmijët dhe nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk diskriminohen në institucionet edukativo-arsimore. Megjithatë, në raste të caktuara raportohet se ekziston një diskriminim pasiv e “i fshehur” ndaj këtyre nxënësve nga ana e mësimit dhe bashkëmoshatarëve të tyre. Kjo vërehet nga fakti se nxënësit e këtyre komuniteteve ulen në bankat e fundit në klasë dhe ka raste kur nxënësit e komuniteteve tjera nuk pranojnë të ulen në bankë me nxënësit e këtyre komuniteteve. Prandaj, pavarësisht se ky fenomen nuk raportohet si gjerësisht i përhapur, megjithatë duhet të ndërmerren fushata për t’i vetëdijësuar mësimit dhe nxënësit për ta luftuar këtë fenomen.

Edukimin parashkollor në çerdhe e kopshte e vijnë një numër shumë i vogël i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo për faktin që vijimi në çerdhe ose kopshte publike e private ka kosto të papërbalueshme për prindërit. Prandaj, komunat duhet të ndajnë kuota të caktuara dhe të mbulojnë shpenzimet e çerdheve publike për vijimin e së paku një numri të caktuar të këtyre fëmijëve.

Një numër i caktuar i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e ndjekin edukimin parashkollor në Qendra Mësimore dhe kjo sadopak e zvogëlon problemin e mos vijimit të edukimit parashkollor nga këta fëmijë. Prandaj, Qendrat Mësimore duhet të përkrahen nga institucionet lokale e qendrore dhe nga donatorët, në mënyrë që të rrisin kapacitetet dhe cilësinë e punës së tyre me fëmijë.

Klasën parafillore e vijnë një numër më i madh i fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, qoftë në kuadër të Qendrave Mësimore qoftë në kuadër të shkollave të rregullta. Por, është me rëndësi që shkollat të rrisin numrin e klasave parafillore, në mënyrë që të rritet numri i fëmijëve të këtyre komuniteteve që e vijnë klasën parafillore.

Për të reduktuar numrin e mungesave dhe rastet e braktisjes së shkollimit të mesëm të ulët nga ana e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duhet të ndërmerren disa masa, si:

- ✓ fushata vetëdijësuese për prindërit, në mënyrë që ata të vetëdijësohen për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve pavarësisht kushteve të rënda ekonomike dhe të mos i ndalin fëmijët nga shkolla për të punuar, për lëmshë, apo për të bërë punët e shtëpisë;
- ✓ donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t’i përkrahin nxënësit e familjeve me gjendje të rëndë sociale me pako shkollore dhe me veshmbathje;
- ✓ mësimitdhënësit lëndorë duhet të trajnohen për të qenë më të informuar dhe të kenë qasje sa më përfshirëse për nxënësit e këtyre komuniteteve;
- ✓ ekipet përkatëse për parandalimin e braktisjes së shkollimit duhet të jenë më efektive për adresimin e këtij problemi, posaçërisht në disa komuna.

Ky problem nuk mund të adresohet në tërësi pa rritjen e punësueshmërisë në mesin e këtyre komuniteteve dhe përmirësimin e mirëqenies së tyre ekonomike në përgjithësi.

Për të rritur numrin e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që regjistrohen dhe vijnë shkollimin e mesëm të lartë duhet të ndërmerren disa masa, si:

- ✓ fushata vetëdijesuese për prindërit me qëllim të zhdukjes së fenomenit të martesave të hershme;
- ✓ donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t'i përkrahin nxënësit e familjeve me gjendje të rëndë sociale me pako shkollore dhe me veshmbathje;
- ✓ donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t'i përkrahin me bursa për shkollim nxënësit e suksesshëm dhe nxënësit e familjeve me gjendje të rëndë sociale (me theks të veçantë atyre të gjinisë femërore);
- ✓ në nivelet paraprake të shkollimit (fillor dhe të mesëm të ulët) duhet të punohet më shumë me nxënësit e këtyre komuniteteve (edhe përmes mësimin shtesë e mësimin plotësues), në mënyrë që suksesi i tyre të përmirësohet dhe ata të jenë në gjendje të regjistrohen në drejtime që ju pëlqejnë dhe të jenë të suksesshëm gjatë shkollimit.

Për të ndikuar në përmirësimin e suksesit të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian gjatë shkollimit, përveç masave të parapara për rritjen e vijueshmërisë dhe parandalimin e braktisjes së shkollimit, duhet të ndërmerren edhe masa të tjera, si

- ✓ përfshirje sa më e madhe në edukimin parashkollor dhe posaçërisht në klasën parafillore;
- ✓ zvogëlimin e mungesave të këtyre nxënësve gjatë shkollimit;
- ✓ shkollat dhe mësimdhënësit duhet të ofrojnë mësim shtesë dhe orë plotësuese për këta nxënës;
- ✓ duhet të ketë programe për zhdukjen e analfabetizmit tek prindërit e këtyre nxënësve;
- ✓ donatorët dhe institucionet qendrore e lokale duhet të përkrahin në forma të ndryshme familjet me gjendje të rëndë ekonomike.

Pavarësisht rolit të rëndësishëm të QM-ve, vlerësohet se ato përballen me disa sfida dhe probleme, prandaj duhet të ndërmarrën masave në funksion të fuqizimit dhe përmirësimit të punës së QM-ve, si:

- ✓ donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t'i përkrahin më fuqishëm dhe sistematikisht QM-të, në mënyrë që ato të mund të pasurojnë aktivitetet e tyre dhe të rrisin numrin e fëmijëve dhe nxënësve që marrin shërbime nga këto qendra;
- ✓ donatorët dhe institucionet lokale e qendrore duhet t'i përkrahin QM-të që të rrisin kapacitetet e tyre profesionale, në mënyrë që puna në QM të jetë sa më profesionale;
- ✓ MASHT duhet të zbatojë kornizën ligjore për funksionimin e QM-ve, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr.12/2017 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore.

Integrimi në shkollimin e rregullt i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët riatdheshohen vlerësohet një problem dhe sfidë e veçantë. Për arsye të ndryshme, procesi i integrimit të këtyre nxënësve zgjatë shumë, prandaj institucionet qendrore dhe lokale duhet të krijojnë mekanizma më efektiv për adresimin e këtij problemi.

Për të ndikuar në rritjen e numrit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që regjistrohen në studime universitare duhet që donatorët dhe institucionet lokale e qendrore t'i përkrahin me bursa për studime studentët e suksesshëm dhe studentët e familjeve me gjendje të rëndë sociale (me theks të veçantë atyre të gjinisë femërore). Gjithashtu, me qëllim të rritjes së regjistrimit dhe mbajtjes së studentëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim të lartë, duhet të organizohen kurse intensive për kandidatët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për t'i përgatitur ata për provimin pranues dhe programe të mentorimit për t'i mbështetur studentët e këtyre komuniteteve gjatë studimeve.

Pjesëmarrja e lartë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në tregun e punës do të përmirësonte produktivitetin ekonomik, do të zvogëlonte shpenzimet qeveritare për asistencë sociale dhe do të rriste të hyrat nga tatimi në të ardhura. Po ashtu, integrimi ekonomik i këtyre komuniteteve do të kontribonte në ndërtimin e kohezionit shoqëror dhe do të përmirësonte respektimin e të drejtave themelore, përfshirë të drejtat e komuniteteve, dhe do të ndihmonte në eliminimin e diskriminimit racor, etnik, social, e tjera.

MPMS në statistikat e rregullta duhet të raportojë në nivel të komuniteteve specifike dhe duhet të publikoj raporte mbi përfitimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga shërbimet e punësimit dhe asistencës sociale dhe masat tjera të ofruara.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë informata të mjaftueshme për zyrat e punësimit, për qendrat e aftësimin profesional, për MATP-të dhe për kategoritë e përfitimit nga skemat sociale. Prandaj, MPMS duhet të organizojë fushata të informimit për këto shërbime dhe të punësojnë këshilltarë të punësimit nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. MPMS duhet të organizojë fushata informuese për skemat e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale dhe kriteret për qasje në këto skema. Po ashtu, kriteret e vlerësimit për të përfituar nga ndihma sociale nuk janë të përshtatshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe duhet rishikuar.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuar në shërbimin civil si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal në krahasim me pjesëmarrjen që kanë në totalin e popullsisë në një komunë të caktuar. Qeveria e Kosovës duhet të zhvillojë mekanizma për monitorimin dhe raportim të rregullt mbi zbatimin e kornizës ligjore për sigurimin e përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në institucione publike në nivel qendror dhe lokal.

